



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT



KORNIZA E VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

Tiranë, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 305/17 Prot.

Tiranë, më 15.01.2025

URDHËR

Nr. 18, datë 15.01.2025

PËR

MIRATIMIN E “KORNIZËS SË VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR” DHE “METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “d” të pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.98, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP) dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani”,


URDHËROJ:

1. Miratimin e “Kornizës së vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social shkollor” dhe “Metodologjisë për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të shërbimit psiko-social shkollor”, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

Orjana Osmani



Grupi koordinues:

Gerti Janaqi - Drejtor i Përgjithshëm, ASCAP

Majlinda Ucaj - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Organizimit të dhe Drejtimit në APU

Esion Zgjana - ASCAP, Specialist ne Sektorin e Kualifikimit dhe Zhvillimit Profesional, pranë Drejtorisë se Kurrikulës dhe Kualifikimit

Eniana Veli - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Zbatimit të Cilësisë

Kontribuan:

- Shkëlqim Allkaj
- Anilza Ferizaj
- Rezarta Basha
- Ekeld Alizoti
- Emanuela Garuli
- Olta Jaçellari
- Orsjola Miha
- Ezmeralda Xheraj
- Entela Burazeri
- Dafina Allkushi
- Mimoza Halili
- Fjorela Broli
- Ermilinda Zgjana
- Jona Hila
- Redon Tafilaku
- Ediola Jaupaj
- Mimoza Tahiri

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	3
HYRJE.....	6
QËLLIMI I KORNIZËS	9
REFERENCAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE	11
ROLI I PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL.....	14
RËNDËSIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL	17
PARIMET E VLERËSIMIT	20
STANDARDET DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE.....	22
KOMPETENCAT THEMELORE	26
VLERAT QË DREJTOJNË PROCESIN E VLERËSIMIT	29
Përfshirja dhe barazia	29
Respektimi i dinjitetit dhe i vlerave individuale	29
Eficienca dhe ndikimi i qëndrueshëm	30
Përgjegjshmëria dhe transparencë	30
Përmirësimi i vazhdueshëm dhe të mësuarit nga praktikat.....	31
Bashkëpunimi dhe ndërveprimi	31
ROLI I DREJTORIT TË SHKOLLËS.....	32
SISTEMI I VLERËSIMIT	35
Vlerësimi i jashtëm i shërbimit psiko-social.....	35
Vlerësimi i brendshëm i shërbimit psiko-social.....	36
FUSHAT E CILËSISË	38
Fusha 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve	39
Fusha 2: Procesi i të nxënësve.....	42
Fusha 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale	44
Fusha 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin	46
TREGUESIT E CILËSISË	48
Treguesit e cilësisë për fushën 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve	49
Treguesit e cilësisë për fushën 2: Procesi i të nxënësve	49
Treguesit e cilësisë për fushën 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale.....	50
Treguesit e cilësisë për fushën 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin	51

PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	52
Fusha e cilësisë 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve	52
Treguesi 1.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe sjelljeve problematike.	52
Treguesi 1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht.	54
Treguesi 1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe të personalizuar.	56
Treguesi 1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë plane për të parandaluar dhe për të trajtuar çrregullime të sjelljes dhe të shëndetit mendor të nxënësve.	58
Fusha 2: Procesi i të nxënësve	60
Treguesi 2.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre unike, në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në mësim dhe vetëbesimin në procesin e të nxënësve.	60
Treguesi 2.2.: Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit, për të përshtatur strategjitë e të nxënësve sipas nevojave individuale të çdo nxënësi, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuara ose nevoja të veçanta edukative.	62
Treguesi 2.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë plane individuale ndërhyrjeje, për të mbështetur nxënësit për përmirësimin e aftësive të tyre të të nxënësve dhe zhvillimin personal.	64
Treguesi 2.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve.	66
Treguesi 2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe qasje të ndryshme që nxisin mësimin aktiv dhe bashkëpunues për nxënësit, duke rritur motivimin dhe përfshirjen e tyre në klasë.	68
Fusha e cilësisë 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale	71
Treguesi 3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve, për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi.	71
Treguesi 3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e nxënësve për të ofruar mbështetje të përshtatshme dhe efektive.	73
Treguesi 3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur, të drejtë dhe të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, prindërve dhe stafit, duke shmangur çdo lloj favorizimi, diskriminimi ose paragjykimi.	75
Treguesi 3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe metoda të strukturuar dhe efektive, për të trajtuar konfliktet dhe situatat e ndjeshme, duke siguruar një zgjidhje që respekton të drejtat dhe ndjenjat e të gjitha palëve.	77

Treguesi 3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuar për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.....	79
Fusha e cilësisë 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin	81
Treguesi 4.1: Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë në vijimësi me familjet dhe komunitetin në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse.....	81
Treguesi 4.2: Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve.....	83
Treguesi 4.3: Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë diversitetin e familjeve dhe të komunitetit, si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.....	85
Treguesi 4.4: Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme, të besueshme dhe të ndershme me familjet dhe komunitetin, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku interesat e fëmijëve janë gjithmonë në qendër të vëmendjes.	87
SHKALLËT E VLERËSIMIT	88
RISKU DHE SFIDAT E VLERËSIMIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL	91
Mungesa e burimeve	91
Mosmarrëveshjet në interpretimin dhe implementimin e kornizës.....	91
Ndikimi i faktorëve të jashtëm	92
Ndërgjegjësimi dhe angazhimi i duhur i familjeve dhe i komunitetit	92
Diversiteti i nevojave të nxënësve.....	92
Rezistenca ndaj ndryshimeve dhe inovacionit	92
BAZA LIGJORE.....	94
BIBLIOGRAFIA.....	97

HYRJE

Shërbimi psiko-social në shkollë është një shtyllë thelbësore e mbështetjes për nxënësit, duke u fokusuar në mirëqenien e tyre emocionale, sociale dhe shkollore. Në një kohë, kur sfidat e përditshme që hasin nxënësit, janë gjithnjë e më të ndërlikuara, shërbimi psiko-social synon të krijojë një mjedis mbështetës dhe të harmonizuar, ku çdo nxënës të ndihet i pranuar, i përkrahur dhe i aftë, për të përmbushur potencialin e tij të plotë. Ky shërbim ka në fokus mirëqenien psiko-emocionale, ndërtimin e aftësive ndërpersonale dhe promovimin e një klime pozitive në klasë dhe në shkollë.

Megjithatë, për të siguruar që shërbimi psiko-social të ketë ndikim real dhe të jetë efektiv, është e domosdoshme një qasje e strukturuar dhe e standardizuar për vlerësimin e cilësisë së tij. Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor është një dokument strategjik, që adreson këtë nevojë, duke përcaktuar parimet themelore, fushat dhe treguesit e cilësisë, si dhe shkallët e vlerësimit.

Kjo kornizë është ndërtuar mbi disa premisa themelore. Së pari, ajo pranon se çdo nxënës ka të drejtë të aksesojë shërbime psiko-sociale cilësore, të përshtatura sipas nevojave të tij individuale. Së dyti, ajo njeh rëndësinë e një qasjeje të integruar, ku punonjësit psiko-socialë bashkëpunojnë me mësuesit, prindërit dhe institucionet përkatëse, për të siguruar një mbështetje gjithëpërfshirëse. Së treti, korniza e konsideron cilësinë si një proces dinamik, që kërkon vlerësim të vazhdueshëm, përshtatje dhe përmirësim, në bazë të ndryshimeve në kontekst dhe në nevojat e nxënësve.

Treguesit e cilësisë përfshijnë një gamë të gjerë aspektesh, duke nisur nga aftësitë dhe profesionalizmi i punonjësve, qasja e tyre ndaj nxënësve, metodat dhe praktikat që përdorin, deri tek angazhimi i komunitetit dhe ndikimi i përgjithshëm në klimën shkollore. Vlerësimi i cilësisë mbështetet në përdorimin e mjeteve dhe të teknikave që janë të matshme, të qarta dhe të ndjeshme ndaj diversitetit të nevojave dhe të konteksteve.

Një tjetër element kyç i kornizës është qasja e saj, që përfshin jo vetëm vlerësimin e shërbimit, por edhe trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit. Ajo siguron që punonjësit psiko-socialë të kenë njohuritë dhe aftësitë më të fundit për të ofruar shërbim cilësor. Korniza gjithashtu,

promovon ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor, duke përfshirë mësuesit, prindërit dhe vetë nxënësit në procesin e krijimit të një mjedisi të shëndetshëm psikologjik dhe social.


Nëpërmjet implementimit të saj, korniza synon të arrijë disa qëllime strategjike. Ajo synon të rrisë cilësinë e jetës në shkollë, të përmirësojë rezultatet shkollore dhe të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësi për të përballuar sfidat e jetës. Gjithashtu, ajo shërben për të identifikuar dhe për të adresuar në kohë problemet emocionale, sociale dhe të sjelljes, duke krijuar kështu, një bazë të fortë për suksesin e nxënësve brenda dhe jashtë shkollës.

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor është e rëndësishme për standardizimin dhe përmirësimin e shërbimit psiko-social në shkollë. Ajo përfaqëson një angazhim të qartë, për të siguruar që çdo nxënës të marrë mbështetjen e duhur në mënyrë profesionale, të qëndrueshme dhe me ndikim pozitiv afatgjatë. Me këtë qasje, shkolla jo vetëm që shërben si një vend edukimi, por edhe si hapësirë që promovon mirëqenien dhe zhvillimin e plotë të çdo individi.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), krijuar në përputhje me VKM-në nr. 98 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, në përmbushje të përgjegjësisë të saj funksionale, monitoron sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, publik dhe privat, si dhe harton standarde, protokolle, rregulla, për ofrimin e shërbimeve arsimore, si dhe vlerëson impaktin e tyre në performancën e institucioneve arsimore parauniversitare, përmes monitorimeve dhe vlerësimeve. Në këtë kontekst, lindi nevoja e hartimit të dokumentit “Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social në shkollë”.

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe të aspekteve të rëndësishme psiko-sociale, duke marrë parasysh objektivat strategjike të edukimit, me vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.

Procesi i hartimit të dokumentit ka kaluar nga procesi i hulumtimit të praktikave ndërkombëtare për funksionimin e shërbimit psiko-social në shkollë, në konsultimin e brendshëm në ASCAP, në diskutimet me bashkëpunëtorë të jashtëm, psikologë shkollorë,



punonjës socialë, mësues, drejtues, ekspertë në fushën e arsimit, të cilët kanë ndihmuar me ide dhe materiale.

Hartimi i këtij dokumenti është mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare, duke pasur parasysh edhe historikun e zhvillimit të strukturës së shërbimit psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

QËLLIMI I KORNIZËS

Qëllimi i Kornizës së Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor është të sigurojë një qasje të qartë dhe të qëndrueshme, që promovon zhvillimin e nxënësve, mirëqenien dhe suksesin e tyre afatgjatë. Ajo vendos bazat për një shërbim cilësor, gjithëpërfshirës dhe me ndikim pozitiv, që mbështet të gjithë komunitetin shkollor. Përmes këtij angazhimi, korniza ndihmon në krijimin e një shkollë, që jo vetëm edukon, por edhe kujdeset dhe fuqizon individët për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor synon të standardizojë dhe të unifikojë mënyrën se si ofrohet, matet dhe përmirësohet ky shërbim jetik për nxënësit. Duke pasur parasysh rolin thelbësor të shërbimit psiko-social në adresimin e sfidave emocionale, sociale dhe akademike të nxënësve, kjo kornizë vendos bazat për një qasje të qëndrueshme dhe efektive që mbështet zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Një nga qëllimet kryesore të kornizës është të sigurojë që çdo nxënës të marrë shërbime cilësore, të personalizuara dhe të aksesueshme. Cilësia e shërbimit vlerësohet, duke u fokusuar në rezultatet e nxënësve, përfshirjen e tyre dhe ndikimin afatgjatë në mirëqenien dhe arritjet e tyre akademike.

Korniza thekson rëndësinë e integritit të shërbimeve psiko-sociale si pjesë e pandashme e sistemit arsimor. Ajo synon të forcojë rolin e punonjësve psiko-socialë, si mbështetës kryesorë për nxënësit, duke i vendosur ata në qendër të përpjekjeve për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme të komunitetit shkollor. Për më tepër, korniza promovon një qasje të integruar, ku shërbimi psiko-social bashkëpunon me mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe prindërit, për të ndërtuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

Një aspekt kyç i kornizës është krijimi i një mekanizmi të qartë dhe të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve psiko-sociale. Qëllimi është të sigurohet, që praktikatat aktuale, të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara dhe të bëhen përmirësime aty ku është e nevojshme. Korniza propozon përdorimin e metodave të matshme dhe të dhënave të bazuara në prova, për të vlerësuar efektivitetin e shërbimeve dhe për të identifikuar praktikatat më të mira.

Korniza synon të sigurojë që shërbimet psiko-sociale të jenë gjithëpërfshirëse, duke adresuar nevojat e nxënësve, pavarësisht prejardhjes së tyre kulturore, ekonomike ose sociale. Ajo vendos në fokus të veçantë përfshirjen e nxënësve që përballen me pengesa të ndryshme, përfshirë sfida emocionale, aftësi të kufizuara ose probleme familjare. Duke promovuar barazinë dhe diversitetin, korniza siguron që çdo nxënës të marrë mbështetjen e nevojshme për të arritur potencialin e tij.

Një qëllim tjetër i rëndësishëm i kornizës, është përmirësimi i vazhdueshëm i aftësive dhe i njohurive të punonjësve psiko-socialë. Ajo inkurajon trajnime të rregullta, zhvillim profesional dhe qasje ndaj burimeve, që i ndihmojnë ata të përdorin praktikatat më të mira. Përmes këtij angazhimi për zhvillim profesional, korniza garanton që shërbimi të jetë gjithmonë në përputhje me standardet bashkëkohore dhe të adresojë sfidat e reja në mjedisin shkollor.

Një tjetër objektivi është të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e shërbimit psiko-social midis mësuesve, prindërve dhe nxënësve. Korniza thekson se mirëqenia emocionale dhe sociale është një komponent kyç i suksesit akademik dhe i zhvillimit personal. Në këtë kuadër, ajo nxit një kulturë, ku shërbimi psiko-social perceptohet si pjesë thelbësore e procesit edukativ.

Korniza synon të ndikojë pozitivisht në klimën shkollore, duke mbështetur krijimin e një mjedisi të sigurt, të respektueshëm dhe mbështetës. Nëpërmjet ndërhyrjeve të strukturuar, ajo ndihmon në reduktimin e konflikteve, në përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe në ndërtimin e një kulture ku bashkëpunimi dhe mirëkuptimi janë normë.

REFERENCAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Në kontekstin e shërbimit psiko-social në shkolla, referencat kombëtare dhe ndërkombëtare luajnë rol të rëndësishëm për marrjen e praktikave më të mira në hartimin e kornizës. Këto burime ndihmojnë, për të siguruar që shërbimet psiko-sociale ofrohen në mënyrë të efektshme, të qëndrueshme dhe profesionale, duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies emocionale dhe sociale të nxënësve. Përmes këtyre referencave, shkollat mund të zhvillojnë dhe të implementojnë praktika të strukturuar, të cilat mbështesin zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve dhe krijojnë mjedis mësimor më të shëndetshëm dhe më produktiv.

Në Shqipëri, aktet ligjore dhe udhëzimet zyrtare janë burime të rëndësishme, që përcaktojnë rolin dhe standardet për shërbimin psiko-social në shkolla. Ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, thekson rëndësinë e mbështetjes psiko-sociale, si pjesë e arsimit të gjithanshëm për nxënësit. Ky ligj u garanton shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore, nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

Një tjetër referencë e rëndësishme është “Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor”, ASCAP 2022. Ky dokument ofron orientime të qarta për detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve psiko-social, duke siguruar që shërbimet që ofrojnë, janë të drejtuara nga praktikatat më të mira dhe nga kërkesat ligjore. Udhëzuesi përfshin procedurat që duhen të ndiqen nga punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor, në identifikimin, në vlerësimin, në ndërhyrjen dhe në parandalimin e problematikave me të cilat nxënësit, prindërit dhe mësuesit përballen në shkollë dhe në familje.

Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” ofron një sërë standardesh të unifikuara, që orientojnë praktikatat dhe shërbimet profesionale të punonjësve të shërbimit psiko-social. Këto standarde profesionale përcaktojnë ndërhyrjet bashkëkohore, promovojnë shërbimet e punonjësve të shërbimit psiko-social për nxënësit, për familjet dhe për shkollat dhe sigurojnë një bazë për të ardhmen e shërbimit psiko-social.

Standardet përkrahin praktikat e duhura të punonjësve të shërbimit psiko-social, në funksion të rezultateve pozitive për nxënësit, për familjet dhe për shkollën në tërësi.

Po ashtu, “Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026”, është një dokument i rëndësishëm, që përfshin në fokus të veçantë, krijimin e kushteve që do të mundësojnë zhvillimin e shërbimeve mbështetëse psiko-sociale në shkolla. Ajo thekson rëndësinë e integritit të këtyre shërbimeve në çdo aspekt të arsimit, përfshirë mbështetje për mësuesit dhe ndihmën për nxënësit që përballen me sfida të ndryshme, duke krijuar një sistem arsimor që përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe të mirëqenies së nxënësve.

Nga ana tjetër, referencat ndërkombëtare janë gjithashtu, shumë të rëndësishme për përcaktimin e standardeve dhe praktikave më të mira për shërbimin psiko-social në shkolla. Një nga referencat kryesore ndërkombëtare është dokumenti i UNESCO-s, i titulluar “*International Guidelines on School-Based Counseling*”. Ky udhëzues ofron standarde dhe praktika të provuara për ndihmën dhe mbështetjen e nxënësve në shkolla. Përcakton se si këshillimi në shkolla, mund të zhvillohet në mënyrë të strukturuar, duke u bazuar në nevojat emocionale dhe sociale të nxënësve dhe se si duhet të trajtohen problemet që mund të paraqiten gjatë procesit mësimor.

Një tjetër dokument është “National Association of School Psychologists” (2020), Model for Comprehensive and Integrated School Psychological Services, NASP, hartuar nga Shoqata Kombëtare e Psikologjisë Shkollore në ShBA (NASP), si një nga shoqatat më prestigjioze në fushën e mirëqenies së nxënësve, në mjediset e institucioneve arsimore.

Po ashtu, Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) ka lëshuar udhëzime të shumta mbi *Mental Health Promotion in Schools*, të cilat theksojnë rëndësinë e shëndetit mendor dhe krijimin e një mjedisi shkollor të shëndetshëm. WHO-ja u rekomandon shkollave, të integrojnë shërbimet psiko-sociale, si pjesë të rëndësishme të politikave të shëndetit mendor dhe të krijojnë mundësi për nxënësit, që të përmirësojnë aftësitë e tyre sociale dhe emocionale. Ky dokument gjithashtu, rekomandon zhvillimin e trajnimeve për mësuesit dhe stafin e shkollës, për t’i ndihmuar ata të përballen me sfidat e shëndetit mendor dhe të krijojnë një atmosferë mbështetëse për nxënësit.

Një tjetër referencë shumë e rëndësishme është American School Counselor Association (ASCA), e cila ka zhvilluar *School Counseling Standards*. Ky standard ndërkombëtar ndihmon në zhvillimin e praktikave më të mira për këshillimin dhe mbështetjen emocionale të nxënësve në

shkolla, duke përfshirë trajnimin e profesionistëve dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit që hasin vështirësi akademike ose sociale.

Një burim tjetër ndërkombëtar është OECD-ja, që në raportin “*The Future of Education and Skills 2030*”, ka theksuar rëndësinë e krijimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse për mbështetjen e nxënësve në shkolla. Ky raport nënvizon rëndësinë e zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale, si komponent i rëndësishëm për suksesin akademik dhe përgatitjen e nxënësve për sfidat e së ardhmes.

Një tjetër dokument i rëndësishëm ndërkombëtar është i UNICEF-it me “*Manuali për Mbështetje Psiko-Sociale në Arsimin Bazë*”, i cili ofron një kornizë për implementimin e shërbimeve psiko-sociale në shkolla, që përfshin mbështetje për nxënësit që përballen me krizë dhe trauma, duke siguruar që ata të kenë mundësinë të zhvillohen në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

Si përfundim, referencat kombëtare dhe ndërkombëtare për standardet dhe praktikat më të mira në shërbimin psiko-social në shkolla, janë burim i rëndësishëm për profesionistët që ofrojnë këto shërbime dhe për të gjithë komunitetin shkollor. Ato ofrojnë udhëzime të qarta dhe të strukturuar, për mënyrën se si mund të zhvillohen dhe mund të implementohen shërbimet mbështetëse në mënyrë efektive, duke siguruar që çdo nxënës të ketë mundësinë të arrijë potencialin e tij të plotë. Përmes këtyre referencave, shkollat mund të krijojnë një mjedis mësimor të sigurt dhe mbështetës, duke u bazuar në praktikat dhe standardet më të mira, që kontribuojnë në mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve.

ROLI I PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

Në shkolla, që çdo ditë përballen me sfida dhe me mundësi të ndryshme, punonjësit e shërbimit psiko-social luajnë rol jetësor në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetës për nxënësit, mësuesit dhe komunitetin. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë ata që dëgjojnë në heshtje, kur një nxënës ka nevojë për mbështetje emocionale, që ofrojnë këshilla, kur mësuesit përballen me situata sfiduese dhe që ndërhyjnë, kur tensionet ndërpersonale mund të kërcënojnë harmoninë e klasës.

Puna e tyre fillon me nxënësit – individë, që përballen me stres akademik, konflikte ndërpersonale apo vështirësi emocionale. Ata janë aty për t'i dëgjuar, për t'u dhënë një hapësirë të sigurt, ku mund të shprehen pa frikë dhe për t'i ndihmuar të gjejnë zgjidhje për sfidat, që i pengojnë në rrugën e tyre drejt suksesit. Për një nxënës që përjeton bullizëm, punonjësi psiko-social bëhet aleati kryesor. Për një tjetër që ndien presionin e notave, ai bëhet mbështetje, që e ndihmon të gjejë balancën midis pritshmërive dhe mirëqenies personale.

Në klasë, roli i tyre është po aq i rëndësishëm. Ata punojnë për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme midis nxënësve, duke ofruar aktivitete që inkurajojnë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Kur shfaqen konflikte, ata janë të parët që ndërhyjnë për të ndihmuar palët, të gjejnë zgjidhje paqësore. Ata ndihmojnë mësuesit, të kuptojnë më mirë sjelljet e nxënësve dhe të zhvillojnë strategji për të krijuar një atmosferë të qetë dhe produktive në klasë.

Por puna e tyre nuk kufizohet vetëm te nxënësit dhe mësuesit. Ata ndërtojnë ura bashkëpunimi me prindërit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë dhe të mbështesin fëmijët e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Në takime dhe seminare, ata ndajnë njohuri dhe strategji, për të trajtuar sfidat e përditshme me të cilat mund të përballen familjet.

Një nga aspektet më të rëndësishme të punës së tyre është ndërgjegjësimi për rëndësinë e shëndetit mendor. Ata krijojnë fushata, organizojnë aktivitete dhe mbajnë trajnime, që ndihmojnë komunitetin shkollor, të kuptojë se mirëqenia emocionale është po aq e rëndësishme, sa ajo akademike. Në këtë mënyrë, ata kontribuojnë jo vetëm në përmirësimin e jetës në shkollë, por edhe në ndërtimin e një kulture, që vlerëson dhe mbështet zhvillimin e gjithanshëm të çdo individi.

Në raste të veçanta, kur një nxënës përballet me sfida serioze emocionale ose sociale, punonjësi psiko-social është aty, për të siguruar që ai ose ajo të mos ndihet vetëm. Ai ndërton një plan mbështetës, që përfshin nxënësin, familjen dhe mësuesit, duke siguruar që asnjë problem të mos mbetet pa zgjidhje. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ndihmon, jo vetëm nxënësin në nivel individual, por edhe krijon një atmosferë, ku çdo anëtar i komunitetit ndien mbështetje dhe kujdes.

Në thelb, roli i punonjësve të shërbimit psiko-social, është ai i një udhërrëfytyesi dhe mbështetësi emocional. Ata janë aty, për të dëgjuar dhe për të vlerësuar nevojat e individëve, për të ndërhyrë kur problemet duken të pazgjidhshme dhe për të siguruar që çdo nxënës, pavarësisht sfidave, të ketë një mundësi për të zhvilluar potencialin e tij. Përmes punës së tyre, ata nuk ndikojnë vetëm në individë të veçantë, por në të gjithë sistemin arsimor, duke kontribuar në krijimin e një shkolle që jo vetëm mëson, por edhe kujdeset.

Rolet kryesore të shërbimit psiko-social janë:

Mbështetja emocionale:	Ndihmon të fuqizojë nxënësit përballë sfidave individuale, emocionale ose ndaj vështirësive në marrëdhëniet ndërpersonale. Kjo është shumë e rëndësishme për të përmirësuar shëndetin mendor dhe për të krijuar një mjedis pozitiv në shkollë.
Parandalimi i problemeve:	Kanë në fokus identifikimin sa më herët të situatave problematike te nxënësit, të tilla si: sjellore, psiko-emocionale, ndërvepruese, të shëndetit mendor, të braktisjes shkollore, social-ekonomike dhe vështirësi në të nxënë. Organizojnë aktivitete dhe trajnime për të ndërgjegjësuar nxënësit dhe stafin në parandalimin dhe eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve dhe anasjelltas, të nxënësve ndaj bashkëmoshatarëve dhe përfshirjes së tyre në sjellje abuzive, të tilla si: konsumimi i duhanit, i alkoolit, i drogës etj.
Ndihma akademike:	Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë faktorët biologjikë, psikologjikë, kulturorë, ekonomikë dhe mjedisorë, që ndikojnë në rezultatet akademike të nxënësve, duke i mbështetur ata për të përmirësuar performancën dhe për të qenë më të motivuar. Ata informojnë punonjësit arsimorë të shkollës, për zhvillimet tipike të moshës të nxënësve dhe për problemet që hasin nxënësit gjatë të mësuarit

	dhe të nxënit. Po ashtu, ata ndihmojnë mësuesit lëndorë dhe ndihmës, për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa.
Këshillimi/ ndërmjetësimi	Psikologët dhe punonjësit socialë ofrojnë këshillim për nxënësit dhe prindërit, në raste konfliktesh apo vështirësish familjare, duke ndihmuar në zgjidhjen e tyre në mënyrë të shëndetshme.
Zhvillimi social dhe i aftësive të jetës	Përmes programeve të ndryshme, ata ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi komunikimi, të mësojnë të përballojnë presionin social dhe të marrin vendime të përgjegjshme. Ata ndihmojnë nxënësit të përshtaten dhe të rritin vetëbesimin, për zhvillimin e aftësive social-emocionale dhe edukimin e tyre në shkollë, nëpërmjet këshillimit/konsultimit individual dhe në grup me nxënës.

RËNDËSIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SHËRBIMIT

PSIKO-SOCIAL

Vlerësimi i cilësisë së shërbimit psiko-social të shkollës, është një komponent i domosdoshëm për të siguruar, që ky shërbim të jetë efektiv, t'u përgjigjet në mënyrë adekuate nevojave të nxënësve dhe të krijojë një mjedis mbështetës dhe të shëndetshëm emocionalisht. Ky proces është i rëndësishëm për shkollat, pasi ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofrohen dhe siguron që ato të plotësojnë standardet e nevojshme, për të mbështetur zhvillimin emocional, social dhe akademik të nxënësve.

Vlerësimi i cilësisë nuk është thjesht një kontroll, por një mundësi për të identifikuar forcën dhe mangësitë e shërbimit dhe për të bërë ndryshime të domosdoshme, që do të përmirësojnë përvojën e nxënësve dhe do të kontribuojnë në krijimin e një atmosfere pozitive dhe produktive në shkollë.

Një nga aspektet më të rëndësishme të vlerësimin të cilësisë, është siguria që shërbimi psiko-social është i efektshëm dhe po i shërben nevojave të nxënësve. Nxënësit mund të përballen me një gamë të gjerë problemesh emocionale dhe sociale gjatë periudhës së shkollës: nga stresi i shkaktuar nga ngarkesa mësimore dhe detyrat, deri te sfidat personale dhe sociale, që mund të ndikojnë negativisht në performancën e tyre akademike. Pa një vlerësim të rregullt, mund të jetë e vështirë të identifikohen problemet e mundshme, që mund të pengojnë zhvillimin e nxënësve. Përmes vlerësimin të cilësisë, mund të sigurohemi që shërbimi është gjithmonë në përputhje me nevojat e nxënësve dhe po i jep mbështetjen e duhur atyre që kanë nevojë më shumë. Ky vlerësim gjithashtu, mund të ndihmojë në identifikimin e aktiviteteve që funksionojnë më mirë dhe të atyre që kërkojnë përmirësim.

Një tjetër element i rëndësishëm është se vlerësimi mund të ndihmojë në përshtatjen e shërbimeve me nevojat e ndryshme të nxënësve. Në çdo periudhë të vitit shkollor, nxënësit mund të përballen me probleme të ndryshme, që mund të ndryshojnë nga një klasë në tjetrën. Për shembull, disa mund të kenë nevojë për mbështetje për menaxhimin e ankthit, që lidhet me provimet, ndërsa të tjerë mund të kenë nevojë për ndihmë më të drejtpërdrejtë, për t'u përballur me çështje më serioze, siç janë konfliktet sociale ose shqetësimet emocionale.


Vlerësimi i shërbimit psiko-social siguron që ky shërbim, të jetë fleksibël dhe të reagojë ndaj këtyre ndryshimeve. Nëse një aktivitet nuk ka pasur efektin e dëshiruar ose një grup nxënësish ka pasur nevojë për mbështetje më të madhe, mund të merren masa korigjuese, që do të mundësojnë përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e ndikimit të tij.

Nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm, shërbimi psiko-social mund të përmirësohet vazhdimisht. Kjo është thelbësore për të siguruar që shërbimi të jetë gjithmonë në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e mbështetjes emocionale dhe sociale. Çdo proces vlerësimi ndihmon në krijimin e mundësive, për të mësuar nga praktikat më të mira dhe për të integruar risitë, që mund të ndihmojnë nxënësit, të përmirësojnë mirëqenien e tyre. Kjo mund të përfshijë implementimin e programeve të reja mbështetëse, si trajnime për aftësitë sociale dhe emocionale, aktivitete që ndihmojnë në menaxhimin e stresit apo edhe mbështetje individuale për ata që kalojnë periudha të vështira.

Një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit të cilësisë është se ai ndihmon në rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies. Duke krijuar një sistem të qartë vlerësimi, drejtorët, mësuesit, punonjësit psiko-socialë dhe prindërit mund të kenë një pasqyrë të qartë mbi efektivitetin e shërbimit që po ofrohet. Vlerësimi mundëson që çdo aktor në shkollë, të mund të identifikojë sukseset dhe mangësitë dhe të marrë masa për të adresuar çështjet e identifikuara. Ky proces ndihmon gjithashtu, në krijimin e një kulture që promovon përmirësimin e vazhdueshëm dhe bën të mundur, që çdo individ të jetë përgjegjës për rezultatet që arrin shërbimi psiko-social.

Një përfitim tjetër i vlerësimit të cilësisë është angazhimi i komunitetit shkollor në përmirësimin e shërbimeve. Pjesëmarrësit në vlerësim, si prindërit, nxënësit dhe anëtarët e stafit, mund të japin sugjerime dhe opinione të vlefshme, që mund të çojnë në përmirësimin e shërbimit. Përmes këtij procesi, krijohet mundësi për të rritur angazhimin e prindërve, për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet shkollës dhe familjeve. Ky angazhim i prindërve dhe i stafit është jetik, për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi shkollor mbështetës dhe për të siguruar që çdo nxënës ka mundësinë të zhvillohet dhe të ketë sukses.

Vlerësimi i cilësisë të shërbimit psiko-social së shkollës është thelbësor, për të siguruar që nxënësit të kenë mbështetje të duhur në përballimin e sfidave të tyre. Ky proces jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e shërbimit, por gjithashtu, kontribuon në krijimin e një shkollë ku të gjithë nxënësit ndihen të sigurt, të mbështetur dhe të motivuar. Përmes vlerësimit të cilësisë,



mund të sigurojmë, që shërbimi psiko-social të ofrohet në mënyrë të qëndrueshme, të përshtatshme dhe efektive, duke kontribuar kështu, në përmirësimin e mirëqenies dhe të performancës së përgjithshme të nxënësve.

PARIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i cilësisë së shërbimit psiko-social në shkolla është proces kompleks dhe i vazhdueshëm, që kërkon angazhim të madh dhe bashkëpunim mes të gjithë aktorëve të shkollës. Vlerësimi i cilësisë duhet të bazohet në disa parime themelore, që ndihmojnë në sigurimin e një procesi të drejtë, të saktë dhe të dobishëm.

Parimet janë themelore, për të siguruar që vlerësimi i cilësisë së shërbimit psiko-social, të jetë i besueshëm, i drejtë dhe të shërbejë si mjet efektiv, për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në shkollë. Përdorimi i këtyre parimeve të vlerësimit, ndihmon në sigurinë e ofrimit të shërbimeve që janë të përshtatshme, efektive dhe mbështetëse për nxënësit, duke kontribuar kështu, në përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe të mirëqenies emocionale të nxënësve.

Këto parime janë:

Objektiviteti:

Vlerësimi duhet të bazohet në kritere të qarta, të paanshme dhe të mirëpërcaktuara. Duhet të shmangët çdo lloj subjektiviteti që mund të ndikojë në rezultatet dhe analizën e performancës së shërbimit psiko-social.

Pjesëmarrja:

Të gjitha palët e interesuara (psikologët, punonjësit socialë, mësuesit, nxënësit dhe prindërit) duhet të kenë mundësinë të japin kontributin e tyre në vlerësim. Pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme, për të marrë një pamje të plotë të ndikimit të shërbimit dhe për të siguruar që vlerësimi pasqyron përvojat dhe nevojat e të gjithëve.

Transparenca:

Procesi i vlerësimit dhe rezultatet duhet të jenë të hapura dhe të kuptueshme për të gjitha palët e përfshira. Transparenca rrit besimin në proces dhe ndihmon që rezultatet të pranohen dhe të përdoren në mënyrë të dobishme.

Konfidencialiteti:

Gjatë vlerësimit, është e rëndësishme të respektohet konfidencialiteti i informacionit personal të nxënësve dhe të stafit.

	Kjo ndihmon në ruajtjen e privatësisë dhe në krijimin e një mjedisi ku individët ndihen të sigurt për të ndarë informacionin e tyre.
<i>Qasja e bazuar në të dhëna dhe prova:</i>	Vlerësimi duhet të bazohet në të dhëna dhe prova të mbledhura në mënyrë sistematike dhe shkencore. Kjo përfshin përdorimin e metodave të matshme dhe të vlefshme, për të siguruar që rezultatet të jenë të sakta dhe të besueshme.
<i>Vlerësimi holistik:</i>	Performanca duhet të vlerësohet në të gjitha aspektet e saj, duke përfshirë ndikimin te nxënësit, prindërit, stafi dhe mjedisi shkollor në përgjithësi. Një vlerësim holistik ndihmon të kuptohet më mirë roli i shërbimit psiko-social në mjedisin e shkollës.
<i>Përshatshmëria dhe përputhshmëria me qëllimet:</i>	Vlerësimi duhet të jetë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e shërbimit psiko-social. Për shembull, nëse qëllimi kryesor i shërbimit është përmirësimi i mirëqenies së nxënësve, atëherë matjet dhe analizat duhet të fokusohen në këtë aspekt.
<i>Vijimësia</i>	Vlerësimi i performancës nuk duhet të jetë një proces i njëhershëm. Ai duhet të kryhet në mënyrë periodike, për të ndjekur përmirësimet dhe për të identifikuar fusha të reja për zhvillim, duke kontribuar kështu, në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit.

STANDARDET DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE

Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të integruara, në 10 fusha të standardeve të përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social. Edukimi universitar, në psikologji shkollor apo punë sociale, përgatit profesionistë me kompetencat themelore profesionale, përfshirë njohuritë dhe aftësitë në 10 fushat, si dhe aftësinë për të integruar njohuritë dhe për të aplikuar aftësitë profesionale, në të gjitha fushat e standardeve profesionale të shërbimeve shkollorë.

Fushat e standardeve profesionale të shërbimit psiko-social janë shumë të ndërlidhura dhe nuk përjashtojnë njëra-tjetrën.

Përshkrimet e shkurtra dhe treguesit e standardeve profesionale, përshkruajnë fushat kryesore të njohurive dhe të aftësive, por nuk kanë për qëllim të pasqyrojnë gamën e gjerë të kompetencave të mundshme të punonjësve të shërbimit psiko-social.

Fusha 1: Marrja e vendimeve të bazuara në të dhëna

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin dhe përdorin metoda vlerësimi, për identifikimin e nevojave dhe të pikave të forta, për zhvillimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve, të programeve efektive, për matjen e progresit dhe të rezultateve, brenda një sistemi mbështetës me shumë nivele. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një model për zgjidhjen e problemeve, si bazë për të gjitha shërbimet profesionale të ofruara. Punonjësit e shërbimit psiko-social sistematikisht, mbledhin të dhëna nga burime të shumta, si bazë për vendimmarrjen në nivele individuale, grupi dhe sistemi dhe konsiderojnë faktorët ekosistemik (p.sh. klasa, karakteristikat e familjes dhe të komunitetit), si kontekst për procesin e vlerësimit dhe të ndërhyrjes.

Fusha 2: Konsultimi dhe bashkëpunimi

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin dhe aplikojnë modele dhe strategji të ndryshme konsultimi dhe bashkëpunimi, të zbatueshme për individët, familjet, grupet dhe sistemet, si dhe metoda për të promovuar zbatimin efektiv të shërbimeve, si pjesë e një procesi sistematik dhe gjithëpërfshirës të vendimmarrjes efektive dhe të zgjidhjes së problemeve, që përfshin të gjitha aspektet e ofrimit të shërbimeve. Punonjësit e shërbimit psiko-social

tregojnë se zotërojnë aftësi për t'u konsultuar, për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar në mënyrë efektive me të tjerët.

Fusha 3: Ndërhyrje në funksion të rritjes së motivimit dhe të arritjes së potencialit të të nxënit

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin ndikimet e faktorëve biologjikë, kulturorë dhe socialë, në aftësitë e të nxënit, në procesin e zhvillimit, në aftësinë njohëse (kognicionin) dhe ofrojnë mbështetje dhe ndërhyrje për nxënësit, këshillim për mësuesin, për familjet, bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë të qendrave komunitare të shëndetit mendor, me qëllim që të përmirësojnë strategjitë e mbështetjes, si dhe bashkëpunojnë me anëtarë të tjerë të shkollës dhe të komunitetit, për të koordinuar shërbimet e nevojshme në funksion të të nxënit. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë arsimorë (stafin pedagogjik), përdorin metoda të vlerësimit dhe të mbledhjes së të dhënave, për të zbatuar dhe për të vlerësuar shërbimet që mbështesin zhvillimin e kompetencave të nxënësit.

Fusha 4: Shërbimet dhe ndërhyrjet për mirëqenien social-emocionale, shëndetin mendor dhe sjelljen

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin ndikimet e faktorëve biologjikë, kulturorë, zhvillimorë dhe socialë në shëndetin mendor, emocionalë dhe të sjelljes dhe përdorin strategji të bazuara në të dhëna, për të promovuar funksionimin social-emocional. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, vlerësojnë, hartojnë, zbatojnë dhe ofrojnë shërbime që promovojnë sjelljen pozitive, krijimin e aftësive sociale dhe aftësive përballuese, që përmirësojnë shëndetin mendor dhe sjelljen.

Fusha 5: Puna në shkolla për të nxitur procesin e të nxënit

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin strukturat, organizimin e sistemeve, programet e arsimit të përgjithshëm dhe special, si dhe praktika të bazuara në të dhëna nga burime të ndryshme, të cilat promovojnë të nxënit, sjelljen pozitive dhe mirëqenien psiko-emocionale. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me stafin pedagogjik, zhvillojnë dhe zbatojnë praktika dhe strategji, për të krijuar dhe për të mbajtur mjedise të sigurt, efektive dhe mbështetëse për nxënësit dhe për stafin e shkollës

Fusha 6: Shërbimet për promovimin e shkollave të sigurt dhe mbështetëse

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin parimet dhe hulumtojnë në lidhje me mirëqenien psikologjike, sociale, emocionale, fuqizimin, faktorët e riskut, shëndetin mendor dhe sjelljen, shërbimet në shkolla dhe komunitete, për të mbështetur, për të parandaluar dhe për të promovuar mirëqenien e shëndetit në shumë nivele dhe strategji të bazuara në të dhëna, për krijimin e shkollave të sigurta dhe mbështetëse. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, promovojnë shërbime parandaluese që rrisin të nxënë, shëndetin mendor, sjelljen e përshtatshme dhe sigurinë psiko-sociale e fizike dhe zbatojnë parandalimin efektiv të krizave, mbrojtjen, zbutjen, reagimin dhe fuqizimin nga krizat.

Fusha 7: Bashkëpunimi i familjes, i shkollës dhe i komunitetit

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin parimet dhe kërkimet që lidhen me sistemet familjare, me pikat e forta, me nevojat dhe kulturat; njohin strategji të bazuara në të dhëna, për të mbështetur ndikimet pozitive të familjes në procesin e të nxënës dhe në mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve; strategji për të zhvilluar bashkëpunimin midis familjeve dhe shkollave. Ata, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, vlerësojnë dhe ndërhyjnë me shërbime që i përgjigjen kulturës dhe kontekstit. Ata lehtësojnë partneritetin shkollë-familje dhe ndërveprimet me organizata/agjenci, për të përmirësuar gjendjen sociale dhe psiko-emocionale, me qëllim rritjen e rezultateve të të nxënës dhe të sjelljes për nxënësit.

Fusha 8: Praktika të barabarta për kategori të ndryshme nxënësish

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri e respekt për dallimet individuale, për aftësitë, për aftësitë e kufizuara dhe karakteristikat e tjera të ndryshme dhe efektet që ato kanë në zhvillimin dhe të nxënës. Ata gjithashtu, njohin parimet dhe hulumtimet që lidhen me diversitetin e nxënës, familjet, shkollat dhe komunitetet, duke përfshirë faktorët që lidhen me zhvillimin e nxënës, me fenë, me kulturën dhe identitetin kulturor, me racën, me orientimin seksual, me identitetin dhe shprehjen gjinore, me statusin socio-ekonomik dhe me ndryshime të tjera. Punonjësit e shërbimit psiko-social zbatojnë strategji të bazuara në të dhëna, për të shtuar shërbimet, si në arsimin e përgjithshëm, ashtu edhe në atë special, dhe për të adresuar ndikimet e mundshme që lidhen me diversitetin. Punonjësit e shërbimit psiko-social demonstrojnë aftësi, për të ofruar shërbime profesionale që promovojnë funksionim efektiv për individët, për familjet dhe për shkollat, me karakteristika, me kulturë dhe me prejardhje të ndryshme etj. Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë se praktikat e barabarta për popullatat e ndryshme të nxënësve, respektimi i diversitetit dhe

advokimi për drejtësinë sociale, janë themelore për ofrimin efektiv të shërbimeve. Ndërsa barazia siguron që të gjithë nxënësit të kenë akses të njëjtë në mundësitë e përgjithshme dhe të veçanta arsimore, paanësia/drejtësia siguron, që secili nxënës, të marrë atë që i nevojitet për të përfituar nga këto mundësi.

Fusha 9: Kërkimi dhe puna e bazuar në të dhëna

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar kërkimin, interpretimin e të dhënave dhe vlerësimin e programeve në mjedise të aplikuara; për përdorimin e metodave kërkimore për hartimin e kërkimeve/raporteve/studimeve, për statistikat, për matjen dhe për teknikat e ndryshme të mbledhjes dhe të analizës së të dhënave. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë dhe zbatojnë kërkimin, si bazë për ofrimin e shërbimeve dhe, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, përdorin teknika dhe burime të ndryshme teknologjike, për mbledhjen, për matjen dhe për analizën e të dhënave, për të mbështetur praktikat efektive tek individi, grupi dhe/ose nivelet e sistemeve.

Fusha 10: Praktika juridike, etike dhe profesionale

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njohuri për historinë dhe për themelet e shërbimeve psiko-sociale dhe të punës sociale në mjediset shkollore; për modele dhe për metoda të shumta shërbimi; për standardet ligjore, etike dhe profesionale, si dhe për faktorë të tjerë që lidhen me identitetin profesional dhe praktika efektive. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë shërbime, në përputhje me parimet ligjore, etike dhe profesionale; angazhohen në vendimmarrje të përgjegjshme, etike dhe profesionale, bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë dhe aplikojnë karakteristikat e punës profesionale, të nevojshme për praktika efektive, duke përfshirë aftësitë ndërpersonale efektive, përgjegjësinë, përshtatshmërinë, iniciativën, besueshmërinë, kompetencën teknologjike, aftësitë e advokimit, respektimin e diversitetit njerëzor dhe përkushtimin ndaj drejtësisë dhe barazisë sociale.

KOMPETENCAT THEMELORE

Kompetencat themelore profesionale të psikologut dhe të punonjësit social të shkollës janë shumë të rëndësishme për të ofruar mbështetje efektive dhe gjithëpërfshirëse për nxënësit, stafin arsimor dhe komunitetin e shkollës. Ato përfshijnë aftësi, njohuri dhe standarde, që punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor duhet të kenë, për të ofruar mbështetje cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

Kompetencat e punonjësve të shërbimit psiko-social janë të ndërtuara mbi parimin e krijimit të një mjedisi mbështetës dhe të sigurt, për zhvillimin dhe mirëqenien e nxënësve, si dhe të një praktike profesionale etike dhe efektive, që respekton të drejtat dhe nevojat individuale të çdo nxënësi.

Sipas udhëzimeve dhe standardeve të BE-së për këtë profesion, kompetencat kryesore të punonjësve të shërbimit psiko-social janë:

- 1. Njohuri të avancuara për zhvillimin dhe sjelljen e nxënësve:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të kenë një kuptim të thelluar të teorive të zhvillimit të nxënësve, të proceseve të të nxënësve dhe të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin akademik dhe emocional të tyre. Ata duhet të njohin fazat e zhvillimit, si dhe faktorët që ndikojnë në sjelljen e nxënësve, për të ofruar mbështetje të përshtatur sipas moshës dhe nevojave të tyre. Kjo përfshin njohuri mbi aspektet kognitive, emocionale dhe sociale të zhvillimit të tyre.
- 2. Vlerësimi psikologjik i nxënësve:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të jenë të aftë të realizojnë vlerësime, për të identifikuar nevojat dhe sfidat individuale të nxënësve. Ata duhet të dinë të përdorin mjete dhe teknika vlerësimi të bazuara në prova, për të kuptuar kapacitetet kognitive, sjelljet, aftësitë sociale dhe emocionet e nxënësve.
- 3. Këshillimi dhe ndërhyrja psiko-sociale:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të kenë aftësi të avancuara në këshillim, për të ndihmuar nxënësit në përballimin e vështirësive emocionale dhe sociale. Ata duhet të jenë të aftë të aplikojnë teknika të ndryshme ndërhyrjeje, për të trajtuar çështje, si: ankthi, depresioni, stresi dhe konfliktet ndërpersonale.
- 4. Ndërhyrje për përmirësimin e shëndetit mendor dhe të mirëqenies:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të kenë aftësi, për të ofruar ndërhyrje të përshtatura, për të

përmirësuar mirëqenien emocionale dhe shëndetin mendor të nxënësve. Ata mund të përdorin teknika këshillimi, programe parandaluese dhe aktivitete ndërgjegjësimi për çështje, si: ankthi, depresioni, bullizmi, vetëbesimi etj.

5. **Përgatitja e planeve edukative individuale:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të jenë të aftë për të përgatitur dhe për të ndjekur plane individuale për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ose që përballen me sfida specifike, duke bashkëpunuar me mësuesit dhe prindërit, për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse.
6. **Zhvillimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës në shkollë:** Një nga kompetencat kyçe është krijimi dhe promovimi i një mjedisi të sigurt për nxënësit dhe stafin. Kjo përfshin ndërhyrje për parandalimin e sjelljeve problematike dhe promovimin e marrëdhënieve pozitive mes nxënësve dhe stafit.
7. **Bashkëpunimi:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të kenë aftësi për të punuar ngushtë me mësuesit, drejtuesit e shkollës, prindërit dhe profesionistët e tjerë. Ky bashkëpunim është thelbësor, për të zhvilluar një qasje të integruar ndaj mbështetjes së nxënësve, për të siguruar që nevojat e tyre të trajtohen në mënyrë të plotë. Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të jenë të aftë për të punuar në ekip, për të mbështetur nxënësit dhe për të ndihmuar përfshirjen e tyre në një mjedis të shëndetshëm shkollor.
8. **Zbatimi i standardeve etike dhe respektimi i konfidencialitetit:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të zbatojnë standardet etike të profesionit, të respektojnë konfidencialitetin e nxënësve dhe të kenë integritet profesional. Ata duhet të mbrojnë të drejtat dhe privatësinë e nxënësve dhe të krijojnë një mjedis të besueshëm, ku nxënësit ndihen të sigurt për të ndarë shqetësimet e tyre.
9. **Menaxhimi i krizave dhe ndërhyrjet emergjente:** Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të jenë të aftë të menaxhojnë situata emergjente, si krizat personale, ngjarjet traumatike ose rastet e bullizmit të rëndë. Ata duhet të jenë të përgatitur për të ofruar mbështetje të shpejtë dhe për të ndihmuar shkollën të rikthehet në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm.
10. **Komunikimi:** Aftësia për të komunikuar qartë dhe me empati me nxënësit, prindërit dhe stafin shkollor është thelbësore. Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të jenë të aftë të dëgjojnë në mënyrë aktive dhe të komunikojnë mesazhet e tyre, në mënyrë që të krijojnë besim dhe të lehtësojnë zgjidhjen e problematikave.
11. **Ndërgjegjësimi dhe edukimi për shëndetin mendor:** Një tjetër kompetencë e rëndësishme është aftësia për të edukuar nxënësit, mësuesit dhe prindërit për çështje të

shëndetit mendor, të tilla si: menaxhimi i stresit, sjelljet pozitive dhe përballimi i sfidave emocionale. Kjo ndihmon në parandalimin e problemeve dhe në përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme në shkollë.

12. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional: Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të angazhohen në përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive dhe të njohurive të tyre përmes trajnimeve dhe zhvillimit profesional, për të siguruar cilësinë më të lartë të shërbimit për nxënësit. Kjo përfshin ndjekjen e praktikave më të mira dhe përditësimin e risive të reja për të përmirësuar cilësinë e shërbimit që ofrojnë.

13. Etika profesionale: Psikologët dhe punonjësit socialë të shkollës duhet të respektojnë standardet etike të profesionit, duke ruajtur konfidencialitetin, duke vepruar në mënyrë të ndershme dhe duke respektuar të drejtat e nxënësve dhe të tjerëve.

14. Menaxhimi dhe dokumentimi i rasteve: Dokumentimi i saktë dhe i plotë i rasteve, ndjekja e protokolleve dhe përgatitja e raporteve të qarta dhe të sakta, janë kompetenca të rëndësishme, për të siguruar që çdo nxënës të marrë mbështetjen e nevojshme.

15. Ndërgjegjësimi dhe parandalimi: Ata duhet të jenë të aftë për të realizuar seanca ndërgjegjësimi për nxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi tema, si: shëndeti mendor, bullizmi, përdorimi i substancave dhe siguria personale.

VLERAT QË DREJTOJNË PROCESIN E VLERËSIMIT

Procesi i vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkolla, është i mbështetur në një sërë vlerash themelore, që udhëheqin dhe formësojnë mënyrën, se si shërbimi ofrohet dhe vlerësohet. Këto vlera janë të rëndësishme, për të siguruar që shërbimi psiko-social të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në zhvillimin psiko-emocional, social dhe akademik të nxënësve. Ato përfaqësojnë standardet dhe parimet etike, që duhet të respektohen gjatë gjithë procesit të vlerësimit, dhe janë thelbësore për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të suksesshme. Më poshtë, janë disa nga vlerat kryesore, që udhëheqin procesin e vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social në shkolla.

Përfshirja dhe barazia

Një nga vlerat më të rëndësishme është përfshirja e të gjithë nxënësve dhe barazia në ofrimin e shërbimit. Shërbimi psiko-social duhet të sigurojë që çdo nxënës, të ketë mundësi të barabarta për të marrë mbështetje dhe për të zhvilluar potencialin e tij, pavarësisht nevojave apo sfidave që po shfaq. Vlerat e përfshirjes dhe të barazisë nënkuptojnë që të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja speciale, ata nga grupe të marginalizuara dhe ata që mund të jenë në kushte të vështira sociale, duhet të kenë qasje në shërbime të cilësisë dhe mbështetje të përshtatshme.

Vlerat e barazisë dhe të përfshirjes sigurojnë që askush të mos mbetet pas në proceset edukative dhe mbështetëse, duke krijuar një mjedis ku çdo nxënës ndihet i vlerësuar dhe i respektuar. Kjo qasje e drejtë dhe gjithëpërfshirëse është thelbësore, për të siguruar që cilësia e shërbimit psiko-social të jetë e lartë dhe për të kontribuar në një zhvillim të balancuar për çdo nxënës.

Respektimi i dinjitetit dhe i vlerave individuale

Një vlerë tjetër e rëndësishme është respektimi i dinjitetit dhe i vlerave të individëve. Shërbimi psiko-social duhet të ofrohet në një mënyrë, që ruan dinjitetin dhe respektin për nxënësit, duke u mundësuar atyre që të shprehin veten në mënyrë të sigurt dhe pa frikë nga gjykimi. Kjo

përfshin mbështetje emocionale dhe sociale, ku çdo nxënës të ndihet i pranueshëm dhe i vlerësuar për atë që është.

Shërbimi psiko-social duhet të krijojë një mjedis ku nxënësit mund të flasin hapur për shqetësimet dhe vështirësitë e tyre, pa pasur frikë nga stigmatizimi. Kjo përfshin, gjithashtu, pranimin e diversitetit kulturor, social dhe emocional të nxënësve, duke u mundësuar atyre të zhvillohen dhe të ndihen të sigurt në shkollë.

Eficienca dhe ndikimi i qëndrueshëm

Procesi i vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social është i orientuar drejt efektivitetit dhe ndikimit të qëndrueshëm. Kjo vlerë është e lidhur ngushtë me mundësinë për të arritur rezultate pozitive dhe të matshme për nxënësit, duke siguruar që shërbimi të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshëm në zhvillimin e tyre. Vlerësimi duhet të fokusohet në përdorimin e metodave dhe të strategjive që kanë treguar efektivitet dhe që mund të përmirësohen vazhdimisht.

Kjo do të thotë që shërbimi psiko-social, duhet të sigurojë mbështetje të vazhdueshme për nxënësit dhe të përshtatet me nevojat e tyre në ndryshim. Shërbimi duhet të monitorohet dhe të vlerësohet, për të siguruar që është i efektshëm dhe ka ndikim pozitiv, duke kontribuar në zhvillimin emocional, social dhe akademik të nxënësve.

Përgjegjshmëria dhe transparenca

Përgjegjshmëria dhe transparenca janë dy vlera të tjera thelbësore, që drejtojnë procesin e vlerësimit të cilësisë. Shërbimi psiko-social duhet të jetë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të cilësisë dhe për mbajtjen e standardeve etike dhe profesionale. Ky proces kërkon që të gjithë aktorët e përfshirë në shërbim – si punonjësit psiko-socialë, mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe prindërit – të jenë të angazhuar dhe të përgjegjshëm për rezultatet që arrihen.

Në të njëjtën kohë, transparenca në procesin e vlerësimit siguron që të gjitha praktikrat dhe vendimet, të jenë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë palët e përfshira. Ky proces mundëson gjithashtu, krijimin e një marrëdhënieje të besueshme mes shkollës, nxënësve dhe prindërve, duke siguruar që informacionet për zhvillimin dhe mbështetjen e nxënësve, të jenë të hapura dhe të disponueshme.

Përmirësimi i vazhdueshëm dhe të mësuarit nga praktikat

Një tjetër vlerë e rëndësishme, është përmirësimi i vazhdueshëm dhe të mësuarit nga praktikat. Ky aspekt i procesit të vlerësimit të cilësisë është thelbësor, për të siguruar që shërbimi psiko-social të evoluojë dhe të përshtatet me kohën dhe me nevojat e nxënësve. Puna me nxënësit kërkon fleksibilitet dhe gatishmëri, për të mësuar nga përvojat e kaluara dhe për të implementuar ndryshime dhe përmirësime që mund të sjellin rezultate më të mira.

Në këtë mënyrë, procesi i vlerësimit të cilësisë siguron një cikël të vazhdueshëm përmirësimi, duke mundësuar që shërbimi psiko-social të jetë gjithmonë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, të shkollës dhe të shoqërisë.

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi janë thelbësorë për procesin e vlerësimit të cilësisë në shërbimin psiko-social. Ky proces kërkon një angazhim të përbashkët nga të gjithë aktorët: punonjësit psiko-socialë, mësuesit, drejtorët e shkollës, prindërit dhe komuniteti. Vetëm përmes një bashkëpunimi të ngushtë dhe të qëndrueshëm, mund të arrihet një mbështetje e plotë për nxënësit dhe të sigurohet që ata të kenë mundësi të zhvillohen dhe të përballojnë sfidat që mund të hasin.

Në përfundim, vlerat që drejtojnë procesin e vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social janë thelbësore për krijimin e një mjedisi shkollor të sigurt, të mbështetur dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e nxënësve. Ato sigurojnë që shërbimi psiko-social të jetë efektiv, gjithëpërfshirës dhe të ndihmojë në përmirësimin e mirëqenies dhe të arritjeve të nxënësve.

ROLI I DREJTORIT TË SHKOLLËS

Drejtori i shkollës luan rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe zhvillimin e shërbimit psiko-social, duke siguruar që nxënësit të kenë mbështetjen e duhur, për të përballuar sfidat emocionale dhe sociale që mund të hasin gjatë periudhës shkollë. Ky rol përfshin krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës, që ndihmon nxënësit të zhvillohen si individë të shëndetshëm emocionalisht dhe të aftë për të menaxhuar ndjeshmëritë e tyre. Drejtori është përgjegjës për integrimin e shërbimeve psiko-sociale në jetën e përditshme të shkollës, duke siguruar që këto shërbime të jenë të aksesueshme dhe efektive për nxënësit.

Një pjesë e rëndësishme e rolit të drejtorit është mbështetja dhe koordinimi i punës së punonjësve psiko-socialë, duke ofruar mundësi për bashkëpunim dhe trajnime për stafin shkollor. Drejtori duhet të sigurojë gjithashtu, burime dhe mbështetje financiare për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve që mbështesin shëndetin mendor dhe emocional të nxënësve. Pjesë e këtij roli është gjithashtu, monitorimi i vazhdueshëm i ecurisë së punës së shërbimit psiko-social në shkollë, përmes vlerësimit të ndikimit dhe të rregullimit të strategjive për përmirësimin e tij.

Në këtë kontekst, drejtori ka përgjegjësinë, për të promovuar një politikë gjithëpërfshirëse dhe të diversitetit, duke siguruar që çdo nxënës, pavarësisht sfidave që mund të ketë, t'i jepet mundësia për të marrë mbështetje. Gjithashtu, ai/ajo duhet të angazhohet për krijimin e partneriteteve me organizata të jashtme, që mund të ofrojnë mbështetje shtesë për nxënësit dhe shkollën. Në këtë mënyrë, drejtori jo vetëm që i vjen në ndihmë shërbimit psiko-social, por gjithashtu, luan një rol kyç, në krijimin e një mjedisi shkollor që mbështet zhvillimin e nxënësve në mënyrë të qëndrueshme dhe harmonike.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës, në mbështetje të shërbimit psiko – social, janë:

Përkrahja dhe integrimi i shërbimeve psiko-sociale në politikën e shkollës

Drejtori i shkollës ka rolin e zhvillimit dhe të zbatimit të politikave që mbështesin mirëqenien emocionale dhe sociale të nxënësve. Ai siguron që shërbimi psiko-social të jetë pjesë e strategjive të përgjithshme të shkollës për zhvillimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetës për të gjithë nxënësit.

Vlerësimi i nevojave të nxënësve

Drejtori i shkollës duhet të sigurojë që nevojat e nxënësve për mbështetje psiko-sociale të identifikohen dhe të adresohen në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Kjo mund të bëhet përmes monitorimit të performancës akademike, ndërveprimeve sociale nga stafi mësimor, duke i adresuar pranë shërbimit psiko-social.

Trajnimi i stafit të shkollës

Drejtori i shkollës duhet të organizojë trajnime, në bashkëpunim me shërbimin psiko-social, për punonjësit mësimorë dhe jomësimorë të shkollës, për t'u njohur me nevojat psiko-sociale të nxënësve dhe për të krijuar një mjedis mbështetës. Stafi mund të ketë nevojë për aftësi në njohjen e shenjave të problemeve emocionale dhe sociale dhe si të drejtojnë nxënësit te shërbimi psiko-social.

Mbështetje për punonjësin social dhe psikologun

Drejtori i shkollës siguron mbështetje dhe burime për psikologun dhe punonjësin social, që të mund të ofrojnë shërbime efikase. Kjo përfshin krijimin e mundësive që ata të angazhohen me nxënësit, të mbajnë mbledhje për rastet që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe për të siguruar resurse dhe mjetet e nevojshme për ta realizuar këtë detyrë.

Përfshirja e familjeve dhe e komunitetit

Drejtori i shkollës duhet të krijojë mundësi për bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin, për të mbështetur zhvillimin psiko-social të nxënësve. Kjo mund të përfshijë organizimin e takimeve informuese për prindërit, aktivitete që inkurajojnë angazhimin e familjeve dhe mbështetje për të përballuar sfidat që nxënësit mund të hasin.

Zhvillimi i planeve për mbështetjen e nxënësve

Drejtori i shkollës mbështet hartimin dhe zbatimin e planeve të ndryshme, në nivel klase dhe shkolle, që ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi sociale dhe emocionale. Këto mund të përfshijnë aktivitete, që adresojnë menaxhimin e stresit, ndihmën për nxënësit me probleme të sjelljes, si dhe plane që promovojnë mirëqenien dhe vetëvlerësimin.

Menaxhimi i krizave dhe i

Drejtori i shkollës duhet të jetë i gatshëm për të menaxhuar situata emergjente, që mund të ndikojnë në shëndetin mendor të nxënësve, siç janë ngjarjet traumatike ose situatat e dhunës. Ai duhet të sigurojë

**situatave
emergjente**

**Mbështetje për
mësuesit në
ndihmën ndaj
nxënësve**

**Monitorimi dhe
vlerësimi i
eficiencës së
shërbimeve psiko-
sociale**

kushtet dhe mbështetje që shërbimi psiko-social të japë kontributin e tij profesional në përballimin e këtyre situatave.

Drejtori i shkollës duhet të krijojë mundësi për mësuesit që të bashkëpunojnë me shërbimin psiko-social, për të identifikuar dhe për të ndihmuar nxënësit që mund të kenë vështirësi emocionale apo sociale. Kjo ndihmon për të siguruar që nxënësit të marrin mbështetje të duhur në kohë dhe të shmangen problemet, që mund të ndikojnë në performancën e tyre akademike dhe zhvillimin e tyre.

Drejtori i shkollës ka përgjegjësinë të monitorojë dhe të vlerësojë efektivitetin e shërbimeve psiko-sociale, për të siguruar që ato po japin rezultate pozitive për nxënësit, pa cenuar konfidencialitetin dhe fushën e ekspertizës.

Kjo mund të përfshijë raportimet e të dhënave nga psikologu, punonjësi social, për të parë nëse shërbimi është duke i adresuar nevojat e nxënësve. Drejtori nxit dhe mbështet zhvillimin profesional periodik dhe të qëndrueshëm të punonjësit të shërbimit psiko-social.

SISTEMI I VLERËSIMIT

Procesi i vlerësimit të shërbimit psiko-social në shkolla, është një komponent i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe për përmirësimin e gjithanshëm të performancës së shërbimeve të mbështetjes psikologjike dhe sociale.

Ky proces ndahet në dy komponentë kryesorë: **vlerësimi i jashtëm** dhe **vlerësimi i brendshëm**, të cilët janë të lidhur ngushtë dhe i shërbejnë njëri-tjetrit, për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe qëndrueshmëri të cilësisë.

Përveç faktit që këto dy procese të vlerësimit ofrojnë një kuptim më të qartë të cilësisë së shërbimit psiko-social, ato ndihmojnë gjithashtu, në rritjen e llogaridhënies dhe të transparencës në shkolla. Përdorimi i një sistemi vlerësimi të ndërlidhur, që përfshin të dhëna nga vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm, siguron që shkolla të jetë gjithmonë në gjendje të monitorojë dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të saj.

Ky proces është thelbësor për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve psiko-sociale, duke mundësuar që shkollat të reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve në nevojat e nxënësve dhe të mbështesin zhvillimin emocional, social dhe akademik të tyre.

Vlerësimi i jashtëm i shërbimit psiko-social

Vlerësimi i jashtëm realizohet nga institucionet monitoruese/vlerësuese, Ky proces ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit të shërbimeve, si dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre shërbimeve.

Rëndësia e vlerësimit të jashtëm qëndron në faktin, se ai ofron një vlerësim të paanshëm dhe të pavarur të cilësisë së shërbimeve, duke siguruar që shërbimi psiko-social të jetë në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe me nevojat e komunitetit shkollor.

Vlerësimi i jashtëm përfshin:

- Vëzhgimin e praktikave dhe të metodave të përdorura nga punonjësit e shërbimit psiko-social.

- Vlerësimin e shërbimeve në përmirësimin e mirëqenies emocionale dhe sociale të nxënësve.
- Shqyrtimin e dokumenteve dhe të raporteve që tregojnë se si janë implementuar shërbimet dhe si janë përdorur burimet për të mbështetur nxënësit me nevoja speciale.

Një vlerësim i jashtëm efikas ofron një pasqyrë të qartë mbi cilësinë e shërbimit psiko-social dhe ndihmon shkollat, për të identifikuar fushat ku mund të përmirësohen dhe për të siguruar që ato po ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë. Gjithashtu, ky vlerësim rrit transparencën dhe llogaridhënien, duke mundësuar që prindërit dhe komuniteti të kenë një pasqyrë të qartë mbi cilësinë e shërbimit.

Vlerësimi i brendshëm i shërbimit psiko-social

Vlerësimi i brendshëm është procesi që realizohet nga vetë shkolla. Ky proces ka për qëllim të vlerësojë, nëse shërbimet psiko-sociale janë të përshtatshme dhe të efektshme për nevojat e nxënësve, si dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm.

Bazuar në “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, MASR, 2020 dhe “Metodologjia për vlerësimin e brendshëm të shkollës”, ASCAP 2020, vlerësimi i brendshëm:

- përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të shkollës, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;
- kryhet çdo vit;
- mbulon të gjitha fushat e cilësisë, në përputhje me “Udhëzuesi për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës”, ASCAP, 2020;
- kryhet në nivel individual (drejtori, nëndrejtori, mësuesi) dhe në nivel organizmesh të shkollës (drejtoria, këshilli i mësuesve, ekipi lëndor).

Punonjësit e shërbimit psiko-social, përveçse kryejnë vetëvlerësimin e tyre, ata kanë një rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, duke kontribuar me ekspertizën e tyre, në aspekte që lidhen me mirëqenien emocionale, sociale dhe psikologjike të komunitetit shkollor. Ata përfshihen në:

- mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga anketat e nxënësve, të prindërve dhe të mësuesve, për të identifikuar çështje, si: stresi dhe ankthi te nxënësit, ndërveprimet sociale dhe konfliktet, mungesat ose problemet në mbështetjen psiko-sociale;
- konsultimin me stafin shkollor për çështjet që ndikojnë në mjedisin e të nxënit;
- grupet e punës për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga shkolla;
- analizimin e faktorëve që ndikojnë në sjelljen dhe në performancën akademike të nxënësve;
- hartimin e raporteve dhe të analizave që lidhen me mirëqenien psiko-sociale të nxënësve;
- mbledhjen dhe në strukturimin e të dhënave për vlerësimin e brendshëm të shkollës;
- analizat e efikasitetit të aktiviteteve psiko-sociale në mjedisin shkollor dhe te nxënësit;
- zbatimin e planit të përmirësimit;
- planet e verpimit, bazuar në gjetjet dhe sfidat e identifikuar;
- në krijimin e urave ndërmjet shkollës, nxënësve, prindërve dhe komunitetit të gjerë etj.

Vlerësimi i brendshëm është i rëndësishëm për disa arsye:

1. **Vetëvlerësimi dhe reflektimi:** Ky proces i mundëson shkollës të reflektojë mbi praktikat dhe aktivitetet që po realizohen dhe të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta.
2. **Përmirësimi i shërbimeve:** Vlerësimi i brendshëm ndihmon në krijimin e planeve të përmirësimit të shërbimit, duke siguruar që nevojat e nxënësve të mbulohen dhe ndërhyrjet të jenë efektive.
3. **Angazhimi i stafit dhe bashkëpunimi:** Ky proces i jep mundësinë të gjithë stafit të shkollës, të jetë i përfshirë në krijimin e një mjedisi mbështetës për nxënësit, duke siguruar që të gjithë të kenë një kuptim të përbashkët të nevojave dhe të prioriteteve të shërbimit psiko-social.

Përmes vlerësimit të brendshëm, shkolla është në gjendje të krijojë një plan përmirësimi të qëndrueshëm, i cili mund të përfshijë trajnime të stafit, përmirësimin e infrastrukturës dhe të burimeve për shërbimet psiko-sociale, si dhe përshtatjen e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e ndryshme të nxënësve.


FUSHAT E CILËSISË

Shërbimi psiko-social në shkolla, ka rol të rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit të nxënësve dhe në krijimin e një mjedisi shkollor të shëndetshëm dhe mbështetës. Fushat e cilësisë janë të lidhura ngushtë me nevojat dhe me sfidat, që nxënësit përballen gjatë periudhës së zhvillimit të tyre, dhe janë thelbësore për ofrimin e mbështetjes adekuate.

Fushat e cilësisë janë shtyllat kryesore që lidhen drejtpërdrejt me gjithë veprimtarinë e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe përcaktojnë performancën e tyre në tërësi.

Përcaktimi i fushave të cilësisë është bazuar në aktet ligjore, qëllimet e arsimit parauniversitar, dokumentet zyrtare për shërbimin psiko-social, përvojat kombëtare dhe qasjet ndërkombëtare.

Korniza e cilësisë së shërbimit psiko-social në shkolla, përqendrohet në katër fusha kryesore, që synojnë të mbështesin zhvillimin gjithëpërfshirës të nxënësve.



Vlerësimi i cilësisë së shërbimit psiko-social sipas katër fushave të cilësisë, ndihmon në krijimin e një mjedisi shkollor, që nxit zhvillimin harmonik, mirëqenien dhe aftësimin e nxënësve për t'u përballur me sfidat e jetës.

Fusha 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve

Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve është një nga fusha më të rëndësishme në shërbimin psiko-social. Nxënësit shpesh, përballen me sfida të ndryshme që lidhen me ndjenjat e tyre, si ankthi, depresioni, dhe ndjenja e pasigurisë, që mund të lindin nga presionet akademike dhe sociale. Kjo fushë ka për qëllim të ndihmojë nxënësit, të zhvillojnë aftësitë e nevojshme, për të menaxhuar emocionet e tyre dhe për të ndërtuar një vetëvlerësim të shëndetshëm.

Përmes aktiviteteve dhe mbështetjes individuale, nxënësit mund të mësojnë, si të identifikojnë dhe të përballen me ndjenjat e tyre dhe si të zhvillojnë empatinë dhe aftësitë për të ndihmuar të tjerët në situata emocionale të ngjashme. Ky zhvillim është thelbësor, për të ndihmuar nxënësit të krijojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të ndihen të sigurt në mjedisin shkollor.

Përveç kësaj, shërbimi psiko-social ndihmon në zhvillimin e aftësive sociale të nxënësve. Ky proces përfshin mësimin e aftësive për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët në mënyrë pozitive dhe për të zgjidhur konfliktet që mund të lindin mes bashkëmoshatarëve. Mënyra se si nxënësit menaxhojnë marrëdhëniet e tyre me të tjerët, ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre dhe në aftësinë për të mësuar dhe për t'u përballur me sfidat akademike dhe sociale.

Zhvillimi emocional dhe social përbën themelin e mirëqenies dhe të suksesit të nxënësve, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si ata mësojnë dhe ndërveprojnë me botën përreth tyre. Kjo fushë thekson rëndësinë e zhvillimit të aftësive emocionale, si vetëdija për emocionet, menaxhimi i stresit dhe përmirësimi i ndjeshmërisë.

Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe ndërhyrjesh, për të adresuar problemet emocionale dhe sjellore, që mund të ndikojnë në zhvillimin dhe performancën shkollore të nxënësve, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetës për zhvillimin e tyre të plotë. Ata janë të trajnuar për të njohur shenjat dhe simptomat e problemeve të shëndetit mendor të nxënësit, siç janë ankthi, depresioni, stresi, çrregullimet e sjelljes dhe problemet e emocionit, duke përdorur metoda të ndryshme për të identifikuar këto probleme, si intervista, vlerësime psikologjike dhe mbikëqyrje të sjelljes.

Për nxënësit që kanë çrregullime si ankthi social, depresioni, PTSD (trauma post-traumatik) ose çrregullime të tjera, punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në zhvillimin e strategjive

për menaxhimin e këtyre kushteve dhe gjithashtu, ofrojnë ndihmë të jashtme profesionale, si terapinë psikologjike ose ndihmën mjekësore.

Nxënësit mund të shfaqin sjellje të papërshtatshme, si agresioni, shpërqendrimi, mungesa e respektit ndaj të tjerëve ose vështirësi në punën në grup. Në këto raste, punonjësit e shërbimit psiko-social janë të përgatitur, për të vlerësuar shkakun e këtyre sjelljeve, për të ndërmarrë veprime për t'i adresuar ato, duke përdorur teknikën e këshillimit dhe strategjitë për menaxhimin e sjelljes.

Për nxënësit që kanë vështirësi të kontrollojnë emocione, të tilla si zemërimi, frika ose frustrimi, punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë trajnime dhe mbështetje për zhvillimin e aftësive të menaxhimit të emocioneve. Kjo mund të përfshijë mësimin e teknikave të qetësimit, si meditimi, frymëmarrja e thellë dhe ndërhyrje të tjera.

Punonjësit e shërbimit psiko-social gjithashtu, ofrojnë mbështetje për nxënësit që kanë nevoja të veçanta, si ato me çrregullime të zhvillimit, autizëm, ADHD ose vështirësi të tjera psikologjike. Ata sigurojnë që këta nxënës të kenë mbështetje adekuate dhe mund të zhvillojnë strategji për të përmirësuar sjelljen dhe për t'u integruar më mirë në mjedisin shkollor.

Një nga funksionet e rëndësishme të punonjësit të shërbimit psiko-social, është zhvillimi dhe realizimi i aktiviteteve edukative për nxënësit, prindërit dhe mësuesit, lidhur me shëndetin mendor. Kjo mund të përfshijë seminare dhe aktivitete ndërgjegjësimit mbi çrregullimet e shëndetit mendor, menaxhimin e stresit, teknikën e relaksimit dhe mbështetje për nxënësit që mund të përjetojnë presion.

Shumë probleme që lidhen me shëndetin mendor dhe sjelljen e nxënësve, mund të kenë lidhje me faktorë të jashtëm, siç janë vështirësitë familjare, varfëria ose trauma. Punonjësit e shërbimit psiko-social punojnë ngushtë me prindërit, për t'i mbështetur ata në menaxhimin e këtyre situatave dhe për t'u siguruar që nxënësit të marrin mbështetje të duhur. Kur është e nevojshme, ata mund të referojnë nxënësit për trajtim të mëtejshëm në shërbime të tjera, si për shembull, terapistë individuale, shërbime mjekësore ose mbështetje për fëmijët që përjetojnë trauma të rënda.

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të përfshirë në zhvillimin e politikave dhe të aktiviteteve që synojnë parandalimin e dhunës, të ngacmimit dhe të bullizmit. Ata mund të

mbështesin nxënësit që janë viktimë të bullizmit dhe mund të punojnë për të ndërgjegjësuar grupet e nxënësve për sjelljen e pranueshme dhe të respektueshme ndaj të tjerëve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të angazhuar në krijimin e një mjedisi që inkurajon mirëkuptimin, respektin dhe bashkëpunimin. Ata punojnë për të siguruar, që nxënësit të ndihen të sigurt dhe të mbështetur në shkollë dhe se kanë mundësi për të shprehur emocionet dhe shqetësimet e tyre, pa frikë nga ndëshkimi.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës së punonjësve të shërbimit psiko-social, është zhvillimi i aktiviteteve edukative dhe i trajnimeve për nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Kjo përfshin trajnime mbi menaxhimin e stresit, ndërgjegjësimin për shëndetin mendor, përballimin me situata të vështira dhe mbështetje për zhvillimin e aftësive sociale. Nxënësit mund të mësojnë se si të ndërveprojnë me të tjerët në mënyrë pozitive dhe të menaxhojnë konfliktet në mënyrë të shëndetshme.

Komponentët kryesorë

- **Vetëdija emocionale:** Ndhurma për nxënësit që të kuptojnë emocionet dhe ndikimin e tyre në sjellje. Organizimi i diskutimeve në klasë për të ndarë emocionet dhe për të ndërtuar vetëbesim.
- 1. **Menaxhimi i emocioneve:** Përmirësimi i aftësive për t'u përballur me presionet emocionale (meditimi, trajnime për menaxhimin e stresit etj.).
- 2. **Empatia dhe marrëdhëniet sociale:** Krijimi i aftësive për të kuptuar dhe për të respektuar ndjenjat dhe perspektivat e të tjerëve.

Nxënësit që përmirësojnë aftësitë e tyre emocionale janë më të përgatitur për të përballuar sfidat akademike dhe sociale. Ata tregojnë më pak prirje për sjellje impulsive dhe ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme.

Fusha 2: Procesi i të nxënit

Procesi i të nxënit është përbërës jetik i cilësisë së shërbimit psiko-social. Ai shkon përtej transferimit të njohurive, duke përfshirë krijimin e një mjedisi që inkurajon kreativitetin, angazhimin dhe vetëdijen.

Procesi i të nxënit përbën themelin e zhvillimit akademik, personal dhe social të nxënësve. Përtej mësimdhënies dhe përthithjes së informacionit, të nxënit ndikohet nga një mori faktorësh kognitivë, emocionalë dhe socialë, të cilët kërkojnë vëmendje dhe mbështetje të vazhdueshme nga punonjësit e shërbimit psiko-social.

Procesi i të nxënit fokusohet në ndihmën që shërbimi psiko-social mund të ofrojë, për të përmirësuar aftësitë akademike të nxënësve. Në këtë fushë, qëllimi është që të ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë strategji të nxënit të suksesshëm. Shpesh, nxënësit përballen me vështirësi të mëdha në mësim, veçanërisht kur ata ndihen të pasigurt ose të mbingarkuar nga detyrat shkollore. Shërbimi psiko-social mund të ofrojë ndihmë, për të identifikuar dhe për të trajtuar këto vështirësi dhe për të ofruar teknika për menaxhimin e stresit dhe përballimin nga presionet shkollore. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e aftësive për menaxhimin e kohës, motivimin për mësim dhe ndihmën për nxënësit që mund të kenë nevoja speciale edukative.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i procesit të të nxënit, është ndihma që shërbimi psiko-social ofron për nxënësit, që mund të kenë vështirësi të mëdha akademike, për shkak të faktorëve të jashtëm, siç janë problemet familjare, shëndetësore apo sociale. Nxënësit që përballen me këto sfida, shpesh, kanë nevojë për mbështetje të veçantë, për t'u integruar në procesin mësimor dhe për të arritur potencialin e tyre të plotë. Puna me këta nxënës është e nevojshme, për të siguruar që ata të kenë mundësi për t'u zhvilluar në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Me një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar, punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të përballojnë sfidat, të zhvillojnë aftësitë dhe të arrijnë një mirëqenie të plotë, duke mbështetur kështu, jo vetëm suksesin akademik, por edhe zhvillimin e përgjithshëm të tyre. Ndërhyrjet e punonjësve të shërbimit psiko-social në procesin e të nxënit, lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien dhe suksesin akademik të nxënësve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në identifikimin dhe adresimin e faktorëve emocionalë, psikologjikë dhe socialë, për të mbështetur të nxënit e nxënësve. Kjo përfshin:

- Ndhimën për nxënësit që përballen me sfida të ndryshme, si p.sh., nxënës me vështirësi të të nxënës, probleme emocionale ose shqetësime të lidhura me marrëdhëniet sociale.
- Përmirësimin e aftësive për përballimin e sfidave akademike dhe të stresit, duke u përqendruar te mbështetja emocionale dhe psikologjike.
- Nxitjen e motivimit për të nxënës, si një komponent thelbësor i suksesit akademik, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi që frymëzon dhe angazhon nxënësit.
- Identifikimin e nevojave individuale të çdo nxënësi dhe qasjet e personalizuara për t'i mbështetur ata.
- Ndërhyrjet që ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë mendore për të mësuar, si dhe aftësitë emocionale për të përballuar stresin dhe sfidat.
- Zhvillimin e aftësive për vetërregullim dhe menaxhimin e emocioneve, për të arritur përqendrimin dhe angazhimin në procesin mësimor.
- Bashkëpunimin me mësuesit dhe me familjet, për të mbështetur zhvillimin akademik dhe mirëqenien e nxënësve.
- Identifikimin e aftësive dhe të nevojave të veçanta të nxënësve: Vlerëson aftësinë e punonjësit për të kuptuar dhe për të adresuar nevojat unike të nxënësve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me stafin mësimor të shkollës, krijojnë kushte që nxisin motivimin, përqendrimin, përfshirjen dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve, për të përballuar sfidat akademike dhe personale. Ata ndihmojnë nxënësit jo vetëm të arrijnë rezultate të mira akademike, por edhe të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për jetën, si vetërregullimi, menaxhimi i stresit, aftësitë sociale dhe vetëbesimi.

Punonjësit psiko-socialë luajnë rol kyç në identifikimin dhe adresimin e faktorëve, që ndikojnë tek të nxënës, duke përfshirë aspektet psikologjike, emocionale dhe sociale. Ata kontribuojnë në krijimin e përvojave pozitive të të nxënës, përmes metodave të ndryshme, si mbështetja emocionale, ndërhyrjet në zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe zbatimimi i qasjeve kreative, për të rritur përfshirjen e nxënësve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë përmirësimin e aftësive të nxënësve për përballimin e stresit dhe vetërregullimin emocional. Ata përdorin metodave të ndryshme për të nxitur të nxënës aktiv dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale, si dhe vlerësojnë kreativitetin dhe efektivitetin e qasjeve të zbatuara, për të përmirësuar përfshirjen e nxënësve.

Ndërhyrjet e punonjësve të shërbimit psiko-social në procesin e të nxënimit të nxënësve, kërkon që ata të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar për nxënësit, duke punuar në mënyrë të integruar me stafin e shkollës dhe familjet. Ata mund të përballen me sfida që përfshijnë:

- identifikimin e nevojave të fshehura të nxënësve;
- mungesën e burimeve të mjaftueshme për zbatimin e ndërhyrjeve të personalizuar;
- angazhimin e kufizuar të aktorëve të shkollës, në procesin e mbështetjes së nxënësve;
- bashkëpunimin e vazhdueshëm mes punonjësve, mësuesve dhe prindërve, për të mbështetur në mënyrë efektive nxënësit etj.

Elementet kryesore të fushës:

1. **Motivimi:** Nxënësit duhet të ndihen të inkurajuar për të mësuar, duke lidhur informacionin me përvojat e tyre personale. Eksperimentet shkencore, vizitat edukative dhe punët e artit ndihmojnë nxënësit të kuptojnë konceptet teorike në praktikë.
2. **Qasjet e personalizuar:** Çdo nxënës ka nevoja dhe stile të ndryshme të të nxënimit, që duhet të respektohen, ndaj duhen përdorur metoda e teknika të personalizuar, që përshtaten me ritmin dhe stilin e nxënësve.
3. **Përdorimi i teknologjisë:** Mjetet digjitale dhe teknologjia ofrojnë mundësi për ta bërë procesin më angazhues dhe interaktiv.

Kur procesi i të nxënimit është efektiv, nxënësit zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik, kreativitetin dhe vetëbesimin.

Fusha 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale

Fusha e sjelljes dhe e marrëdhënieve ndërpersonale përqendrohet në menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme dhe në ndihmën për të krijuar një mjedis shkollor të shëndetshëm. Shpesh, nxënësit mund të përjetojnë vështirësi në menaxhimin e sjelljeve të tyre, si agresiviteti, dhuna verbale apo fizike, dhe mungesa e aftësive për të komunikuar në mënyrë të efektshme me të tjerët.

Shërbimi psiko-social luan rol kyç në ndihmën për menaxhimin e këtyre sjelljeve, duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë pasojat e veprimeve të tyre dhe duke ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive të menaxhimit të konflikteve dhe të komunikimit të shëndetshëm.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj fushe, është edhe trajtimi i bullizmit dhe i sjelljeve të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e nxënësve. Shërbimi psiko-social është i angazhuar për të krijuar një atmosferë, ku nxënësit të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur, për të mësuar se si të respektojnë ndjenjat dhe kufijtë e të tjerëve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit që shfaqin probleme në ndërveprimet sociale, si nxënësit që kanë vështirësi të krijojnë miqësi, të komunikojnë në mënyrë efektive ose që mund të kenë sjellje agresive, ose të ngacmojnë të tjerët. Për këtë, mund të ofrohen mundësi për t'u përfshirë në grupe mbështetjeje, ku ata mund të praktikojnë aftësi sociale, si bashkëpunimi, empatia dhe të menduarit për pasojat e veprimeve të tyre.

Kjo fushë fokusohet në mënyrën se si nxënësit ndërtojnë dhe mbajnë marrëdhënie të qëndrueshme, duke përfshirë aftësitë për të menaxhuar konfliktet dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

Komponentët e fushës:

1. ***Komunikimi efektiv:*** Shprehja e ideve dhe e ndjenjave me respekt dhe qartësi. Organizimi i lojërave dhe i aktiviteteve grupore.
2. ***Zgjidhja e konflikteve:*** Ndërtimi i aftësive për të përballuar situatat e tensionuara pa agresion.
3. ***Puna në grup:*** Përforsimi i aftësive për të bashkëpunuar dhe për të respektuar diversitetin.
4. ***Mentorimi:*** Trajnimi për të kuptuar dhe për të menaxhuar situatat e konfliktit.

Nxënësit që zhvillojnë marrëdhënie të shëndetshme, ndihen më të përfshirë dhe më të pranuar, duke krijuar klimë shkollore mbështetëse.

Fusha 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

Një shkollë e suksesshme ndërton ura bashkëpunimi dhe komunikimi me prindërit dhe komunitetin, për të siguruar që zhvillimi i nxënësve mbështetet nga të gjitha palët. Punonjësit e shërbimit psiko-social luajnë rol shumëdimensional në krijimin e partneriteteve midis shkollës dhe familjeve, duke promovuar mbështetjen për ndikimin pozitiv të familjes, në të nxënit dhe shëndetin mendor të nxënësve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin pikat e forta dhe nevojat specifike kulturore, të cilat shërbejnë si bazë për zhvillimin e strategjive efektive, që promovojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin e fëmijëve. Këta profesionistë janë të aftë të hartojnë, të zbatojnë dhe të vlerësojnë shërbime që respektojnë diversitetin kulturor dhe kontekstin specifik të komunitetit. Përmes bashkëpunimit me agjencitë e komunitetit, psikologët e shkollës ndihmojnë në përmirësimin e rezultateve akademike dhe të sjelljeve sociale të fëmijëve, duke mbështetur zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Nga ana tjetër, punonjësit e shërbimit psiko-social kanë përgjegjësi, për të siguruar komunikim të vazhdueshëm, transparent dhe të përgjegjshëm me familjet dhe komunitetin. Kjo formë komunikimi siguron, që mjedisi shkollor të jetë gjithmonë i sigurt dhe mbështetës për fëmijët. Përmes një qasjeje të tillë, përforcohen lidhjet ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit, duke siguruar që mirëqenia psiko-sociale e fëmijëve të jetë prioritet.

Punonjësit psiko-socialë luajnë një rol vendimtar në ndërtimin e një kulture shkollore të hapur dhe të respektueshme, ku diversiteti perceptohet si një avantazh i çmuar dhe jo një pengesë. Kjo jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e marrëdhënieve brenda shkollës, por gjithashtu, kontribuon në formimin e nxënësve, që respektojnë dhe vlerësojnë ndryshimet dhe janë më të përgatitur për të bashkëvepruar me një shoqëri të larmishme, ku toleranca dhe bashkëpunimi janë thelbësorë për suksesin dhe mirëqenien e tyre të ardhshme.

Bashkëpunimi efektiv midis shkollës, familjes dhe komunitetit, ndihmon në krijimin e një mjedisi, ku të gjithë aktorët punojnë së bashku, për të mbështetur zhvillimin dhe mirëqenien e të gjithë nxënësve. Ky partneritet krijon një bazë të qëndrueshme për suksesin e nxënësve, si brenda mjedisit shkollor, ashtu edhe më gjerë, në jetën e tyre të përditshme.

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm, transparent dhe të përgjegjshëm me familjet dhe komunitetin. Ky lloj komunikimi ndihmon në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës, duke siguruar që nevojat dhe interesat e fëmijëve të jenë gjithmonë në qendër të kujdesit të ofruar.

Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë, që komunikimi me familjet dhe komunitetin të jetë i vazhdueshëm, duke ndërtuar një mjedis mbështetës, që përmirëson mirëqenien psiko-sociale të nxënësve dhe përforcon lidhjet ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit. Komunikimi i hapur dhe bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin, ndihmojnë në krijimin e një mjedisi shkollor që është mbështetës, i sigurt dhe i përshtatshëm për nevojat e të gjithë nxënësve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime për prindërit, duke iu ofruar njohuri dhe aftësi, për të mbështetur në mënyrë efektive zhvillimin emocional, social dhe akademik të fëmijëve të tyre.

Shumë shpesh, nxënësit përballen me sfida që lidhen jo vetëm me jetën e tyre shkollore, por edhe me jetën e tyre familjare dhe sociale. Shërbimi psiko-social luan rol kyç në krijimin e një rrjeti mbështetës që përfshin prindërit, mësuesit dhe komunitetin. Angazhimi i prindërve është thelbësor, për të siguruar që mbështetja që ofrohet në shkollë, të jetë në përputhje me nevojat e nxënësve dhe të vazhdojë edhe jashtë shkollës.

Përfshirja e komunitetit është gjithashtu e rëndësishme, pasi mund të ofrojë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve dhe të grupeve mbështetëse, që ndihmojnë nxënësit të integrohen dhe të zhvillohen.

Komponentët e fushës

1. ***Përfshirja e prindërve:*** Bashkëpunimi i prindërve në vendimmarrjet dhe aktivitetet e shkollës. Diskutimi i progresit dhe i nevojave të nxënësve me prindërit.
2. ***Angazhimi i komunitetit:*** Shkollat duhet të lidhen me burimet dhe mundësitë e ofruara nga organizatat lokale.
3. ***Zhvillimi i projekteve të përbashkëta:*** Krijimi i iniciativave që përfshijnë nxënësit, familjet dhe anëtarët e komunitetit. Zhvillimi i aktiviteteve të bamirësisë, që zhvillojnë përgjegjësinë sociale.

Bashkëpunimi i fortë ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit, forcon zhvillimin e nxënësve dhe krijon mbështetje të gjithanshme.

TREGUESIT E CILËSISË

Për secilën fushë cilësie janë përcaktuar treguesit e cilësisë, të cilët ndihmojnë për të konstatuar shkallën e cilësisë së shërbimit psiko-social. Treguesit e cilësisë janë sasiorë dhe cilësorë dhe përdoren për të monitoruar dhe për të vlerësuar cilësinë e shërbimit që ofrohet nga punonjësit e shërbimit psiko-social.

Treguesit e cilësisë janë përcaktuar, për të vlerësuar përmbushjen e nevojave të nxënësve dhe për të siguruar që mbështetja psiko-sociale ofrohet në mënyrë të përshtatshme dhe efikase. Ata ndihmojnë në identifikimin e pikave të forta dhe dobësive të shërbimit, duke siguruar që aktivitetet dhe ndërhyrjet psiko-sociale të jenë të përshtatshme për nevojat specifike të çdo nxënësi.

Një nga funksionet kryesore të treguesve të cilësisë është përmirësimi i shërbimeve. Duke përdorur këta tregues, specialistët mund të identifikojnë fushat ku mund të përmirësohen strategjitë dhe metodat e përdorura për të mbështetur nxënësit. Kjo përfshin përshtatjen e shërbimeve dhe aktiviteteve psiko-sociale, në përputhje me nevojat e ndryshme të nxënësve, siç janë ata me nevoja speciale, vështirësi akademike, sociale ose emocionale. Në këtë mënyrë, shërbimet psiko-sociale mund të bëhen më të përshtatshme dhe më të efektshme, për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e tyre personal dhe akademik.

Një tjetër funksion i rëndësishëm i treguesve të cilësisë, është vlerësimi i efektivitetit të strategjive të përshtatura të mësimdhënies, si dhe identifikimi i mundësive për t'i përmirësuar ato, duke siguruar që mësimdhënia për nxënësit të jetë sa më e përshtatshme dhe e suksesshme.

Përveç kësaj, treguesit e cilësisë ndihmojnë për të përmirësuar bashkëpunimin me mësuesit dhe prindërit, për të siguruar mbështetje të plotë dhe të integruar për nxënësit.

Treguesit e cilësisë kontribuojnë në përmirësimin e politikave dhe të praktikave shkollore, duke ofruar informacion të vlefshëm për drejtuesit e shkollave, mbi nevojat e nxënësve dhe ndikimin e shërbimeve psiko-sociale. Ky informacion mund të përdoret për të zhvilluar politika të reja ose për të përmirësuar ato ekzistuese, që mund të sigurojnë mbështetje më të mirë dhe më të qëndrueshme për nxënësit.

Treguesit e cilësisë për fushën 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve

- 1.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe të sjelljeve problematike.
- 1.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht.
- 1.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe të personalizuar.
- 1.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë plane, për të parandaluar dhe për të trajtuar problematika të sjelljes dhe të shëndetit mendor të nxënësve.

Treguesit e cilësisë për fushën 2: Procesi i të nxënit

- 2.1.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre unike, në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në mësim dhe vetëbesimin në procesin e të nxënit.
- 2.2.** Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe me prindërit, për të përshtatur strategjitë e të nxënit sipas nevojave individuale të çdo nxënësi, veçanërisht për ata me vështirësi specifike ose me nevoja të veçanta edukative.
- 2.3.** Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë plane të personalizuar ndërhyrjeje, për të mbështetur nxënësit për përmirësimin e aftësive të tyre të të nxënit dhe zhvillimin personal.
- 2.4.** Punonjësit e shërbimit psiko-social i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve.

2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe qasje të ndryshme, që nxisin mësimin aktiv dhe bashkëpunues për nxënësit, duke rritur motivimin dhe përfshirjen e tyre në klasë.

Treguesit e cilësisë për fushën 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale

3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve, për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi.

3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykime të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe të nevojat e nxënësve, për të ofruar mbështetje të përshtatshme dhe efektive.

3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur, të drejtë dhe të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, prindërve dhe stafit, duke shmangur çdo lloj favorizimi, diskriminimi ose paragjykimi.

3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe metoda të strukturuar dhe efektive, për të trajtuar konfliktet dhe situatat e ndjeshme, duke siguruar një zgjidhje që respekton të drejtat dhe gjendjen emocionale/ndjenjat e të gjitha palëve.

3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuar për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.

Treguesit e cilësisë për fushën 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

- 4.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë në vijimësi me familjet dhe komunitetin në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse.
- 4.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve.
- 4.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.
- 4.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme, të besueshme dhe të ndershme me familjet dhe komunitetin, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës në interesin më të lartë të fëmijëve.

PËRSHKRUESIT PRAKTIKË

Përshkruesit praktikë (treguesit specifikë) janë fjali përshkruese për vëzhgimin në praktikë të procesit të vlerësimit. Ata përcaktojnë se si është hartuar, është zbatuar dhe si është zhvilluar treguesi i cilësisë. Nëpërmjet përshkruesve praktikë mblidhet informacioni dhe të dhënat e shkollës dhe vlerësohet cilësia e përmbushjes së treguesve të cilësisë.

Fusha e cilësisë 1: Zhvillimi emocional dhe social i nxënësve

Treguesi 1.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe sjelljeve problematike.

- | |
|--|
| <p>1.1.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda të ndryshme vlerësimi (si: vëzhgimi, intervistimi, listëkontrolli etj.), për vlerësimin e sjelljes së nxënësve.</p> |
| <p>1.1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista individuale me nxënësit, për të kuptuar ndryshimet emocionale dhe sjellore.</p> |
| <p>1.1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë, fokusgrupe, për të mbledhur të dhëna, në funksion të vlerësimit të sjelljes së nxënësve.</p> |
| <p>1.1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë analizat periodike dhe vjetore të shkollës dhe raportet e stafit të shkollës, për të vlerësuar ndryshimet në sjellje.</p> |
| <p>1.1.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara (listëkontrolli, teste etj.), për identifikimin e problematikave emocionale të nxënësve.</p> |
| <p>1.1.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë faktorët e jashtëm, që ndikojnë në mirëqenien sociale dhe emocionale të nxënësve, nëpërmjet vëzhgimeve dhe komunikimit me nxënësit dhe familjet e tyre.</p> |
| <p>1.1.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë fokusgrupin me nxënësit, si metodë për të vlerësuar përfshirjen dhe angazhimin e tyre në jetën shkollë.</p> |

- 1.1.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësimi, për të matur nivelin e stresit të nxënësve.
- 1.1.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë aftësitë e nxënësve, për të menaxhuar dhe për të zgjidhur konflikte dhe i ndihmojnë ata.
- 1.1.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve, gjatë veprimtarisë në mjediset e shkollës.
- 1.1.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë burime të dhënash nga shërbime të tjera (si: terapi, mbështetje të jashtme etj.), për të kuptuar më gjerë nevojat dhe ecurinë e nxënësve.
- 1.1.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara, vetëraportuese, listëkontrolli, teste etj., për vlerësimin e vetëvlerësimit, të vetëkontrollit dhe menaxhimin e emocioneve të nxënësve.
- 1.1.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të edukimit bashkëmoshtar (si grupet mbështetëse), për nxënësit me vështirësi sjellore dhe emocionale.
- 1.1.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin materiale edukative, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë dhe të menaxhojnë emocionet (libra, fletushka, aktivitete online etj.), për t'u mësuar nxënësve si të kuptojnë dhe të menaxhojnë emocionet e tyre.
- 1.1.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social referojnë për shërbime të specializuara (si vlerësim i thelluar, trajtim etj.), nxënësit të cilët manifestojnë vështirësi sjellore ose emocionale, kur vlerësojnë që ndërhyrjet brenda shkollës nuk janë të mjaftueshme.

Treguesi 1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, ku ata mund të shprehin veten dhe të zhvillohen emocionalisht.

1.2.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë ose fokusgrupe, për të vlerësuar klimën në shkollë.
1.2.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve në mjediset shkollore.
1.2.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë pjesë në grupet e diskutimit dhe në organizimin e aktiviteteve, që promovojnë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për nxënësit.
1.2.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social shqyrtojnë raportet e stafit të shkollës mbi sigurinë në shkollë.
1.2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna, për të vlerësuar besimin dhe sigurinë e nxënësve në shkollë.
1.2.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social evidentojnë dhe monitorojnë rastet e bullizmit dhe të dhunës.
1.2.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin masa të ofrojnë ose të referojnë për shërbime më të specializuara nxënësit në nevojë për mbështetje sociale.
1.2.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna, për të vlerësuar nivelin e stresit dhe të mirëqenies psiko-emocionale të nxënësit.
1.2.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe analizojnë të dhëna, për të vlerësuar nivelin e shqetësimeve që lidhen me shëndetin mendor të nxënësve (ankthin, depresionin etj.).
1.2.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete dhe veprimtari praktike me nxënësit, me qëllim mësimin e aftësive të qëndrueshme, për të menaxhuar stresin dhe për të përballuar situatat sociale të vështira.

- 1.2.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë hapësira të dedikuara për mbështetjen emocionale të nxënësve.
- 1.2.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teknika të ndryshme ndërhyrjeje për përmirësimin e sigurisë emocionale të nxënësve.
- 1.2.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit për integrimin në aktivitetet që mbështetesin zhvillimin social.
- 1.2.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit në situata që shkaktojnë pasiguri (kriza, emergjenca etj.).
- 1.2.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete trajnuese/informuese për mbështetjen e mësuesve dhe të nxënësve dhe për ndihmën e parë psikologjike.

Treguesi 1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë dhe mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe të personalizuar.

<p>1.3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë në bashkëpunim me mësuesit, nxënësit me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta.</p>
<p>1.3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit lëndorë dhe ndihmës, për hartimin e planeve individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara.</p>
<p>1.3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit lëndorë dhe ndihmës, për hartimin e planeve individuale për nxënësit me nevoja të veçanta.</p>
<p>1.3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për përshtatjen e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta.</p>
<p>1.3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për vlerësimin e gjendjes së nxënësve me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta dhe ecurinë e tyre</p>
<p>1.3.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me prindërit për vlerësimin e gjendjes së nxënësve me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta dhe ecurinë e tyre.</p>
<p>1.3.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për angazhimin e nxënësve të tjerë, në mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta.</p>
<p>1.3.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin e shkollës për angazhimin e nxënësve me nevoja të veçanta në aktivitete mësimore dhe sociale, me qëllim integrimin e tyre në grup.</p>
<p>1.3.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të standardizuara, për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve individuale mbi performancën sociale dhe akademike të nxënësve me nevoja të veçanta.</p>
<p>1.3.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë në mënyrë periodike ndryshimet në sjellje dhe zhvillimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta.</p>

- 1.3.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika kreative, si lojërat ose artin, për të ndihmuar nxënësit të shprehin emocionet e tyre, duke ndihmuar që ata të rriten nga pikëpamja psiko-socio-emocionale.
- 1.3.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë drejtuesit e shkollës, mësuesit dhe prindërit për ecurinë e nxënësve, mbi zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale.
- 1.3.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta, për të bashkëpunuar me specialistë të fushave përkatëse, për përmbushjen dhe nevojat terapeutike, rehabilituese etj.
- 1.3.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë seanca informuese, trajnime me mësuesit, mbi aftësinë e kufizuar dhe nevojat e veçanta të nxënësit.
- 1.3.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit, bazuar në analizën e funksioneve të sjelljes, në ofrimin e ndihmës dhe të mbështetjes për menaxhimin e sjelljes të nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta në klasë.

Treguesi 1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë plane për të parandaluar dhe për të trajtuar çrregullime të sjelljes dhe të shëndetit mendor të nxënësve.

<p>1.4.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësuese për identifikimin e nxënësve që shfaqin simptoma të depresionit dhe të ankthit ose problematika të tjera që lidhen me shëndetin mendor dhe mirëqenien e nxënësve.</p>
<p>1.4.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente vlerësuese për identifikimin e nxënësve që manifestojnë problematika sjellore.</p>
<p>1.4.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë dhe zbatojnë plane për trajtimin e sjelljeve problematike.</p>
<p>1.4.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë ndikimin e ndërhyrjeve të aplikuara për trajtimin dhe përmirësimin e sjelljeve sociale.</p>
<p>1.4.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë ecurinë e nxënësve në mjedisin e shkollës, kur nxënësi merr shërbime dhe terapi të specializuara jashtë insitucionit arsimor.</p>
<p>1.4.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin dhe përpunojnë të dhëna për të vlerësuar pasojat e dhunës dhe të bullizmit.</p>
<p>1.4.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë instrumente të standardizuara, vetëraportuese, listëkontrolli, teste etj., për vlerësimin e vetëkontrollit dhe menaxhimin e sjelljes të nxënësit.</p>
<p>1.4.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë ndryshimet në sjelljen e nxënësve në raste krize dhe emergjence.</p>
<p>1.4.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë mbi ecurinë dhe efektivitetin e planeve të ndërhyrjes në përmirësimet e sjelljeve të papërshtatshme.</p>
<p>1.4.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë te drejtuesit e shkollës dhe prindërit mbi ndihmën që u kanë ofruar nxënësve në raste krize dhe emergjence.</p>

1.4.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë sjelljet dhe efektivitetin e ndërhyrjeve për rastet që kanë marrë trajtim dhe mbështetje psiko-sociale.

Fusha 2: Procesi i të nxënit

Treguesi 2.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të identifikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre unike, në mënyrë që të përmirësojnë përfshirjen në mësim dhe vetëbesimin në procesin e të nxënit.

2.1.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme, si: vëzhgime, intervista, pyetësorë dhe teste, për të identifikuar aftësitë dhe nevojat e nxënësve në të nxënë.

2.1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme vlerësimi, për të ndihmuar nxënësit të reflektojnë mbi aftësitë e tyre dhe mundësitë për përmirësim.

2.1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista individuale me nxënësit, për të kuptuar më mirë aftësitë e tyre, pasionet dhe interesat, të cilat mund të ndikojnë në përfshirjen e mëtejshme në procesin mësimor.

2.1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione nga prindërit, mësuesit dhe aktorë të tjerë të shkollës, për të krijuar një pamje më të plotë të aftësive dhe të potencialeve të nxënësve.

2.1.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin në vijimësi të dhëna nga stafi i shkollës, për përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme në klasë dhe jashtë saj, për të analizuar faktorët që ndikojnë në angazhimin ose jo të nxënësve.

2.1.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teste diagnostikuese të standardizuara për vlerësimin e aftësive të veçanta akademike të nxënësve, në funksion të hartimit të strategjive mbështetëse për përmirësimin e tyre.

2.1.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me prindërit për përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj, për të analizuar faktorët që ndikojnë në angazhimin ose jo të nxënësve dhe ndikimin e aktiviteteve shkollore.

2.1.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për organizimin e aktiviteteve me nxënësit, me qëllim zhvillimin e aftësive të tyre.

<p>2.1.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë të dhënat e mbledhura në lidhje me arritjet e nxënësve dhe përfshirjen e tyre në veprimtaritë në klasë dhe shkollë, për të orientuar mësuesit si të ofrojnë mbështetje ndaj nxënësve në fushat që kanë nevojë për përmirësim.</p>
<p>2.1.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social raportojnë në vijimësi te drejtuesit e shkollës dhe stafi mbi arritjet dhe vështirësitë e nxënësve brenda kufijve të konfidencialitetit.</p>
<p>2.1.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë plane individuale për nxënësit, me qëllim zhvillimin e aftësive dhe përmirësimin e angazhimit në procesin mësimor.</p>
<p>2.1.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë sesione informuese, aktivitete sociale në grup për nxënësit, për t'i ndihmuar në forcimin e vetëbesimit dhe përfshirjen në procesin mësimor.</p>
<p>2.1.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë vazhdimisht zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe vlerësojnë rregullisht përparimin me qëllim përshtatjen e strategjive mbështetëse.</p>
<p>2.1.14. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi, që nxënësit të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre, me qëllim përmirësimin e zhvillimin e tyre akademik dhe personal, duke krijuar mundësi për reflektim dhe vetëvlerësim.</p>
<p>2.1.15. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë raporte periodike mbi ndërhyrjet dhe rezultatet e tyre në arritjet e nxënësve, bazuar në objektivat e planifikuara.</p>

Treguesi 2.2.: Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit dhe prindërit, për të përshtatur strategjitë e të nxënësve sipas nevojave individuale të çdo nxënësi, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuara ose nevoja të veçanta edukative.

<p>2.2.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë/fokusgrupe me mësuesit, për të mbledhur mendime dhe sugjerime mbi mënyrën e përshtatjes së metodave të mësimdhënies, në përputhje me nevojat individuale të nxënësve dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative.</p>
<p>2.2.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione nga prindërit, për të kuptuar nevojat e veçanta të fëmijëve dhe për të siguruar që strategjitë e të nxënësve të përshtaten me kërkesat e tyre individuale.</p>
<p>2.2.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë mësimdhënien dhe punën e mësuesve, për të vlerësuar implementimin e strategjive individuale për nxënësit, duke identifikuar mundësitë për përmirësime dhe përshtatje të mëtejshme të metodave.</p>
<p>2.2.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit në mënyrë të vazhdueshme, për të analizuar të dhënat dhe për të siguruar përfshirjen e çdo nxënësi.</p>
<p>2.2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë mësuesit dhe prindërit, të zhvillojnë aktivitete të ndryshme që i përshtaten nevojave të nxënësve dhe që kontribuojnë në përmirësimin e angazhimit të tyre në procesin mësimor.</p>
<p>2.2.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë rezultatet dhe ndikimin e metodave të mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative dhe rekomandojnë ndryshime ose përmirësime në strategjitë e përdorura.</p>
<p>2.2.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë udhëzime dhe këshilla për mësuesit, në lidhje me përmbushjen e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative.</p>
<p>2.2.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin shkëmbimin e ideve dhe të praktikave mes mësuesve, për të siguruar se strategjitë e mësimdhënies janë të përshtatura për nevojat individuale të nxënësve.</p>

2.2.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit të integrojnë teknologjinë dhe mjetet didaktike, për të mbështetur nxënësit në procesin e të nxënit dhe për t'i bërë mësimet më të përshtatshme për ata.

2.2.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit për implementimin e programeve të veçanta mbështetëse për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta edukative, për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për suksese shkollore dhe sociale.

2.2.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të standardizuara, për të vlerësuar ecurinë e nxënësve në lidhje me metodat individuale të të nxënit dhe ndikimin e këtyre metodave në performancën shkollore dhe sociale.

2.2.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin në konsideratë informacionin e dhënë nga nxënësi dhe prindi mbi efektivitetin e strategjive dhe ndikimin e tyre në përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve në procesin mësimor.

2.2.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë ndikimin e ndërhyrjeve në dinamikën e mësimimit dhe në adresimin e nevojave të nxënësve në klasë.

Treguesi 2.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë plane individuale ndërhyrjeje, për të mbështetur nxënësit për përmirësimin e aftësive të tyre të të nxënësve dhe zhvillimin personal.

2.3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social evidentojnë nevojat specifike të nxënësve në aspektet akademike dhe emocionale.
2.3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë pyetësorë për vetëvlerësimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e nevojave në të nxënë dhe zhvillimin personal.
2.3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë me prindërit, për të mbledhur opinione mbi fushat ku ata vërejnë nevoja ose sfida të veçanta të fëmijët e tyre.
2.3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista të strukturuar me nxënësit, për të kuptuar sfidat dhe nevojat e veçanta të tyre.
2.3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista dhe metoda të tjera vlerësuese me mësuesit, për të marrë informacion mbi vështirësitë dhe nevojat e nxënësve të tyre.
2.3.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë të dhëna mbi vështirësitë dhe arritjet e nxënësve, në funksion të vlerësimit të ecurisë së tyre.
2.3.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social vëzhgojnë sjelljet e nxënësve gjatë mësimin, duke identifikuar fusha ku ata kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme.
2.3.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë mësuesit për përshtatjen e metodave të të nxënësve me nevojat specifike të nxënësve.
2.3.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë teste të standardizuara, për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në fusha të caktuara dhe identifikimin e nevojave individuale.
2.3.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin instrumente të ndryshme, për të matur aftësitë socio-emocionale dhe nevojat për mbështetje në këto fusha.

2.3.11.	Punonjësit e shërbimit psiko-social përcaktojnë fushat që kërkojnë ndërhyrje parësore, bazuar në nevojat e vlerësuara.
2.3.12.	Punonjësit e shërbimit psiko-social përshkruajnë progresin e nxënësve, bazuar në hapat e ndjekur përgjatë ndërhyrjes.
2.3.13.	Punonjësit e shërbimit psiko-social dokumentojnë realizimin e objektivave të vendosur për nxënësit dhe sfidat specifike që ata hasin.
2.3.14.	Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë metoda vlerësuese, për të matur aftësinë e nxënësve në përballimin e sfidave shkollore ose emocionale dhe për të zbuluar fusha që kërkojnë përmirësim.
2.3.15.	Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë nivelin e angazhimit dhe motivimit të nxënësve, për të identifikuar nevojat e tyre për mbështetje shtesë.
2.3.16.	Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë intervista me prindërit, për të mbledhur mendime mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe për të identifikuar nevoja të reja që mund të kenë lindur.
2.3.17.	Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë mendimet e tyre me nxënësit mbi përfitimet e ndërhyrjeve, për të përmirësuar planet e ndërhyrjeve.
2.3.18.	Punonjësit e shërbimit psiko-social aplikojnë metoda vlerësuese, për të matur nivelin e vetëbesimit të nxënësve në të nxënë, i cili ndikon drejtpërdrejt në angazhimin dhe përparimin e tyre.
2.3.19.	Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin në konsideratë informacionin e dhënë nga mësuesi, mbi efektivitetin e ndërhyrjeve të përdorura dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e aftësive dhe të sjelljes së nxënësve.
2.3.20.	Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vazhdimësi cilësinë dhe përputhshmërinë e planeve me nevojat e nxënësve.

Treguesi 2.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve.

<p>2.4.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda vlerësimi, si vëzhgime, intervista, listëkontrolli, për të identifikuar qëndrimin e nxënësit në zgjidhjen e problemeve.</p>
<p>2.4.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë tema që lidhen me aftësinë e nxënësve për të zgjidhur problemin përmes të menduarit kritik, duke ofruar mbështetje dhe udhëzime për zhvillimin e procesit të të menduarit kritik dhe strategjive të zgjidhjes së problemeve.</p>
<p>2.4.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë këshillime individuale ose në grup me nxënës, bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe analizave të bëra për kapacitetin e nxënësve për të menduar dhe për të zgjidhur probleme.</p>
<p>2.4.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin strategji të përshtatshme dhe teknika vlerësimi për identifikimin e vështirësive dhe pikave të forta individuale.</p>
<p>2.4.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të ndryshme vlerësuese, si intervista me prindër dhe mësues, për vlerësimin e aspektit socio-emocional të nxënësve, me qëllim përmirësimin e aftësive të nxënësve për të menduar dhe për të zgjidhur problemet.</p>
<p>2.4.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e aftësive të nevojshme, për të komunikuar në mënyrë efektive, për të sintetizuar njohuritë dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe aplikimin e tyre në situata jetësore.</p>
<p>2.4.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë këshillim, ndërhyrje në krizë, mentorim, për të ndihmuar nxënësit të aftësohen në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve.</p>
<p>2.4.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë takime në grup, ku nxënësit nxiten të praktikojnë situata për zgjidhjen e problemeve, zhvillojnë të menduarit kritik, duke përdorur metoda, si diskutime në grup, lojë me role dhe aktivitete të tjera interaktive.</p>

- 2.4.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit të përdorin teknika për zgjidhjen e situatave dhe lojëra didaktike, për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve në kontekste reale.
- 2.4.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtatin ndërhyrjet individuale dhe në grup, për të përmirësuar aftësitë e nxënësve në të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, bazuar në nevojat dhe aftësitë e çdo nxënësi.
- 2.4.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë konsulta dhe këshillime me nxënësit, për t'i ndihmuar ata të njohin pikat e forta dhe dobësitë e tyre në lidhje me të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve.
- 2.4.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete me grupe nxënësish, planifikuar sipas nevojave dhe përshtatura sipas grupmoshës, me qëllim zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve të nxënësit.
- 2.4.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje për zhvillimin e aftësive të nxënësve, për të reflektuar mbi përvojat e tyre mësimore dhe për të analizuar mënyrat, për të përmirësuar qasjet e tyre në të menduarin dhe zgjidhjen e problemeve.
- 2.4.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika vlerësimi, për të identifikuar dhe për të ndihmuar nxënësit që kanë vështirësi në të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe zhvillojnë strategji për të mbështetur përparimin e tyre.
- 2.4.15.** Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në zbatimin e strategjive të të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në projekte dhe detyra individuale, duke përfshirë mbikëqyrjen dhe ofrimin e feedback-ut për përmirësim.

Treguesi 2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe qasje të ndryshme që nxisin mësimin aktiv dhe bashkëpunues për nxënësit, duke rritur motivimin dhe përfshirjen e tyre në klasë.

<p>2.5.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me nxënësit, për të vlerësuar perceptimin e tyre mbi mbështetjen e marrë nga mësuesit në motivimin dhe përfshirjen në klasë.</p>
<p>2.5.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa/pyetësorë me nxënësit, për të kuptuar përvojat e tyre dhe ndikimin e ndërhyrjeve psiko-sociale në nxitjen e mësimin aktiv dhe bashkëpunues.</p>
<p>2.5.3. Punonjësit psiko-social orientojnë mësuesit të përdorin teknika motivuese, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë rëndësinë e mësimin për zhvillimin e tyre personal dhe profesional.</p>
<p>2.5.4. Punonjësit psiko-social ndihmojnë nxënësit të vendosin qëllime konkrete dhe të arritshme, për t'i mbajtur ata të angazhuar dhe të motivuar gjatë gjithë procesit mësimor.</p>
<p>2.5.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete në grup me nxënësit, përmes situatave reale ose të simuluar, për të praktikuar bashkëpunimin dhe rritjen e aftësive sociale.</p>
<p>2.5.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë lojëra edukative, detyra që kërkojnë zgjidhje të problemeve në grup apo aktivitete kreative që nxisin mendimin kritik.</p>
<p>2.5.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi të komunikimit dhe të bashkëpunimit, si dhe të praktikojnë empatinë për të kuptuar më mirë ndjenjat dhe perspektivat e të tjerëve.</p>
<p>2.5.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje individuale për nxënësit që hasin vështirësi, si në aspektin akademik, ashtu edhe në atë emocional.</p>
<p>2.5.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social punojnë individualisht me nxënësit, për të adresuar çështje specifike që mund të ndikojnë në angazhimin dhe motivimin e tyre,</p>

ose mund të organizojnë këshillim grupi, për të rritur vetëbesimin dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve.

2.5.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë mësuesit si të integrojnë teknikat e të mësuarit aktiv dhe bashkëpunues gjatë procesit mësimor.

2.5.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë mësuesit të realizojnë aktivitete që nxisin më shumë angazhim dhe përfshirje të nxënësve dhe sugjerojnë mënyra të ndryshme për të inkurajuar nxënësit gjatë mësimi.

2.5.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social rekomandojnë ose përdorin platforma online, ku nxënësit mund të punojnë bashkërisht në projekte ose mund të përdorin aplikacione edukative, që i bëjnë nxënësit të zhvillojnë aftësi të reja në një mënyrë më interaktive.

2.5.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit për të krijuar projekte dhe aktivitete ndërdisiplinore, që ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi për të punuar në grupe dhe për të zgjidhur probleme komplekse.

2.5.14. Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë vëzhgime në klasë, për të dokumentuar pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e nxënësve në aktivitete, për rastet për të cilat është kryer ndërhyrje.

2.5.15. Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë në vijimësi ndikimin e mbështetjes psiko-sociale në angazhimin dhe progresin e nxënësve.

2.5.16. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë grupe diskutimi me nxënësit, për të vlerësuar mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe motivimin e krijuar.

2.5.17. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë anketa, pyetësorë ose intervista me mësuesit dhe prindërit, për të marrë mendimet e tyre mbi ndryshimet në motivimin dhe përfshirjen e fëmijëve të tyre në shkollë.

2.5.18. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin informacion nga mësuesit për efektivitetin e teknikave kreative dhe bashkëpunuese të zbatuara nga ata.

2.5.19. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë për efektet që ka pasur në përmirësimin e performancës së nxënësve, bashkëpunimi ndërmjet shërbimit psiko-social, mësuesve dhe prindërve.

Fusha e cilësisë 3: Sjellja dhe marrëdhëniet ndërpersonale

Treguesi 3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një komunikim të qartë, të saktë dhe të përshtatur për grupin e synuar, duke respektuar gjithmonë mendimet dhe ndjenjat e të gjitha palëve, për të krijuar një mjedis mirëbesimi dhe bashkëpunimi.

3.1.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social fillojnë çdo bisedë duke përshëndetur me ton të ngrohtë dhe miqësor, për të krijuar një atmosferë të rehatshme dhe mirëpritëse për palët.

3.1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, për të shpjeguar çështje psiko-sociale me terma të lehtë për t'u kuptuar, duke shmangur përdorimin e fjalëve teknike të komplikuar.

3.1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social ushtrojnë veprimtarinë në një mjedis ku nxënësit ndihen të sigurt për të shprehur ndjenjat dhe shqetësimet e tyre pa frikë nga gjykimi.

3.1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtatin mënyrën e komunikimit sipas moshës dhe nivelit të të kuptuarit të nxënësve.

3.1.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në fund të çdo takimi, përmbledhin pikat kryesore të bisedës për të siguruar komunikim efektiv.

3.1.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social, reagojnë me ndjeshmëri dhe empati ndaj shqetësimeve të nxënësve, duke treguar mirëkuptim, përkushtim dhe mbështetje.

3.1.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social i kushtojnë vëmendje të plotë secilës palë, duke dëgjuar pa ndërprerje dhe duke treguar respekt për mendimet dhe ndjenjat e tyre.

3.1.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin gjuhë pozitive për të motivuar nxënësit, për të krijuar besim, duke inkurajuar dhe duke nxitur vetëbesimin e nxënësve, për t'i frymëzuar ata të arrijnë qëllimet e tyre.

3.1.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social shpjegojnë me qartësi të plotë hapat që duhet të ndiqen, duke siguruar që të gjitha palët të kenë udhëzime të qarta për veprimet e mëtejshme.

3.1.10.	Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë privatësinë e informacionit të ndarë dhe sigurojnë që çdo komunikim të trajtohet në përputhje me standardet e etikës profesionale.
3.1.11.	Punonjësit e shërbimit psiko-social prezantojnë rregullat dhe udhëzimet e shkollës në mënyrë të kuptueshme dhe të saktë, duke ndihmuar nxënësit dhe prindërit të ndihen të informuar dhe të mbështetur.
3.1.12.	Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një atmosferë bashkëpunimi, duke nxitur palët të punojnë së bashku për arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta.
3.1.13.	Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin përdorimin e gjuhës kritikuese ose të ngarkuar emocionalisht, duke mënjanuar çdo koment që mund të perceptohet si kritikë apo akuzë.
3.1.14.	Punonjësit e shërbimit psiko-social planifikojnë dhe organizojnë takime në mënyrë efektive, duke konsideruar kohën dhe mundësinë e të gjitha palëve, duke e bërë komunikimin efikas dhe produktiv.
3.1.15.	Punonjësit e shërbimit psiko-social ftojnë të gjitha palët të kontribuojnë në diskutime, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të konsiderohet në vendimmarrje.
3.1.16.	Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë qetësinë dhe profesionalizmin në situata të tensionuara, duke menaxhuar emocionet personale, për të ruajtur një komunikim konstruktiv.
3.1.17.	Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë pjesëmarrjen e nxënësve dhe të prindërve në procesin e vendimmarrjes, për të ndërtuar mirëkuptim dhe për të rritur përgjegjësinë e përbashkët.
3.1.18.	Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të gjitha pikëpamjet e ndryshme të shprehura në diskutime, duke qëndruar neutral dhe profesional në ndërveprime.

Treguesi 3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje dhe pa paragjykim të gjithë nxënësit, duke u përqendruar te shprehjet emocionale dhe te nevojat e nxënësve për të ofruar mbështetje të përshtatshme dhe efektive.

3.2.1	Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurohen që nxënësit të kenë mundësinë të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre pa ndërprerje, duke i dhënë hapësirën e nevojshme për të komunikuar lirshëm dhe pa frikë.
3.2.2	Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika të dëgjimit aktiv (si shprehje të fytyrës dhe sinjale joverbale), për të treguar se është plotësisht i angazhuar dhe i fokusuar në fjalët dhe emocionet e nxënësit
3.2.3.	Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin pyetje të hapura, duke i dhënë mundësinë nxënësit të shpjegojë ndjenjat dhe mendimet e tij në një mënyrë më të thellë.
3.2.4.	Punonjësit e shërbimit psiko-social shprehin empati dhe mbështetje për ndjenjat e nxënësit, duke përdorur fraza që tregojnë se e kupton dhe e vlerëson emocionin e tij.
3.2.5.	Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të vëmendshëm ndaj shprehjeve të fytyrës dhe gjuhës së trupit të nxënësit, për të zbuluar ndjenja apo emocione që mund të jenë të fshehura, si ankthi, frika ose pasiguria.
3.2.6.	Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë shënime të detajuara gjatë bisedave me nxënësit, duke u fokusuar te çështjet dhe shqetësimet kryesore, për të siguruar që asnjë informacion i rëndësishëm nuk humbet dhe mund të përdoret për mbështetje të mëtejshme.
3.2.7.	Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë çdo shqetësim me seriozitet dhe përkushtim të plotë, duke siguruar që çdo situatë trajtohet me respekt dhe përgjegjshmëri.
3.2.8.	Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të artikulojnë më qartë ndjenjat e tyre, duke përdorur pyetje udhëzuese dhe mbështetje, për të ndihmuar në shprehjen emocionale.

3.2.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social u krijojnë mundësi nxënësve për të shpjeguar shqetësimet e tyre, duke i inkurajuar të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre dhe duke u dhënë kohën e nevojshme.

3.2.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin riformulimin, për t'u siguruar që ka kuptuar saktësisht informacionin që ka dhënë nxënësi dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të ndodhin.

3.2.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social orientojnë nxënësit drejt mundësive për zgjidhjen e shqetësimeve të tyre, duke i ndihmuar të fokusohen te zgjidhjet praktike dhe pozitive për problemet që mund të hasin.

3.2.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që çdo vendim dhe ndërhyrje të bëhet duke pasur prioritet nevojat dhe interesat e nxënësve.

3.2.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje për nxënësit në procesin e vendimmarrjes, duke i udhëzuar dhe duke i ndihmuar të marrin vendime të informuara për situatat që ata përjetojnë.

3.2.14. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve kulturore, sociale dhe emocionale që nxënësit mund të përjetojnë, duke qenë të hapur dhe të kujdesshëm, për të kuptuar dhe për të mbështetur këto ndryshime në mënyrë të përshtatshme.

Treguesi 3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur, të drejtë dhe të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, prindërve dhe stafit, duke shmangur çdo lloj favorizimi, diskriminimi ose paragjykimi.

<p>3.3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë qëndrim të barabartë ndaj çdo nxënësi, duke i trajtuar të gjithë pa dallim, pavarësisht nga pozita sociale etnia apo statusi ekonomik etj.</p>
<p>3.3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin gjuhën që mund të krijojë paragjykime apo mund të përforcojë stereotipe, duke siguruar që të gjitha palët të ndihen të barabarta dhe të respektohet çdo diferencë.</p>
<p>3.3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis të ngrohtë dhe miqësor, ku çdo nxënës ndihet i mirëpritur dhe i përfshirë, duke krijuar mundësi për bashkëpunim dhe integrim të të gjithë nxënësve.</p>
<p>3.3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë diversitetin kulturor, social dhe emocional të nxënësve, duke vlerësuar kultura, besime, përvojat e ndryshme të nxënësve dhe duke promovuar respektin për këto dallime.</p>
<p>3.3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social i kushtojnë të njëjtën vëmendje dhe përkushtim të gjitha kërkesave të nxënësve dhe prindërve, pa bërë dallime, duke siguruar që çdo kërkesë të trajtohet me seriozitet dhe profesionalizëm.</p>
<p>3.3.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social shmangin praktikat që mund të favorizojnë nxënësit për shkak të marrëdhënieve personale, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.</p>
<p>3.3.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që të gjitha procedurat e mbështetjes së nxënësve të jenë të qarta dhe të disponueshme për të gjithë, pa diskriminim ndaj grupeve të caktuara.</p>
<p>3.3.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social përfshijnë nxënësit me nevoja të veçanta në aktivitete shkollore dhe sociale, duke u dhënë mundësi të barabarta për zhvillim dhe integrim.</p>

3.3.9.	Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë çdo ankesë apo shqetësim në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke siguruar një qasje të ekuilibruar dhe profesionale në çdo situatë.
3.3.10.	Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me nxënësit, prindërit dhe stafit e shkollës, duke promovuar një atmosferë respekti dhe ndihme të ndërsjellë.
3.3.11.	Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtat e nxënësve, privatësinë dhe konfidencialitetin, për çdo informacion të ndjeshëm që mund të ndahet gjatë ofrimit të mbështetjes psiko-sociale.
3.3.12.	Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi për nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre pa pasur frikë nga gjykimi.
3.3.13.	Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje individuale për nxënësit, duke përshtatur shërbimet për të përmbushur nevojat e tyre specifike, pa diskriminim.
3.3.14.	Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit që përballen me diskriminimin ose padrejtësitë, duke i ndihmuar ata t'i adresojnë dhe të përballen me situatat e tilla.
3.3.15.	Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që të gjitha politikat e shkollës dhe praktikat mbështetëse të jenë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke promovuar barazinë dhe mundësitë për të gjithë nxënësit.
3.3.16.	Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë me veprimtari të ndryshme, barazinë gjinore dhe mbështetje të barabartë për të gjithë nxënësit.

Treguesi 3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe metoda të strukturuar dhe efektive, për të trajtuar konfliktet dhe situatat e ndjeshme, duke siguruar një zgjidhje që respekton të drejtat dhe ndjenjat e të gjitha palëve.

<p>3.4.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin të dhëna nga të gjitha palët e përfshira në konflikt, duke bërë pyetje të qarta dhe neutrale, për të kuptuar burimin dhe shkaqet e konfliktit.</p>
<p>3.4.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social dëgjojnë me vëmendje personat e përfshirë, duke i lënë të shprehin plotësisht mendimet dhe ndjenjat e tyre pa ndërhyrje.</p>
<p>3.4.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social propozojnë alternativa të ndryshme për zgjidhjen e konfliktit, duke u siguruar që të jenë të pranueshme për të gjitha palët.</p>
<p>3.4.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë një mjedis të qetë dhe neutral, ku të gjithë ndihen të lirë për të diskutuar dhe për të dhënë mendimet e tyre.</p>
<p>3.4.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika ndërmjetësimi për të ndihmuar pajtimin e palëve, si ndarja e përgjegjësive apo bashkëpunimi, për t'i ndihmuar të arrijnë një zgjidhje të drejtë dhe të kënaqshme.</p>
<p>3.4.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social ruajnë një qëndrim neutral dhe të drejtë gjatë trajtimit të konflikteve, duke shmangur çdo lloj favorizimi apo anësie.</p>
<p>3.4.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë raste pozitive nga përvoja, për t'u treguar nxënësve mënyra efektive dhe të shëndetshme në trajtimin e mosmarrëveshjeve.</p>
<p>3.4.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë prindërit për mënyrën e menaxhimit të konflikteve dhe i përfshijnë ata si partnerë në procesin e zgjidhjes.</p>
<p>3.4.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social tregojnë kujdes të veçantë ndaj emocioneve të palëve të përfshira, duke përdorur një qasje që respekton ndjenjat dhe përvojat e tyre.</p>
<p>3.4.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social analizojnë thellë shkaqet kryesore të konfliktit, për të krijuar strategji parandalimi në të ardhmen.</p>

3.4.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë nxënësit të propozojnë strategji të thjeshta dhe praktike për parandalimin dhe zgjidhjen e situatave të ngjashme në të ardhmen, duke nxitur mendimin kritik dhe përfshirjen.

3.4.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social hartojnë një plan konkret veprimi pas zgjidhjes së konfliktit, për hapat që duhet të ndjekin të gjitha palët për të zbatuar zgjidhjen.

3.4.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë dinamikën midis palëve pas zgjidhjes së konfliktit, për të garantuar që marrëdhëniet janë përmirësuar dhe që zgjidhja ka qenë efektive.

Treguesi 3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe stafit, duke përdorur qasje të strukturuar për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.

3.5.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë takime të rregullta me nxënësit, prindërit dhe stafit e shkollës, për të diskutuar çdo shqetësim, sfidë apo problem që mund të lindë, dhe për të shqyrtuar mundësitë e zgjidhjeve të përbashkëta që kontribuojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve.

3.5.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete të përbashkëta, për të forcuar bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërmjet nxënësve, stafit dhe prindërve, duke krijuar mundësi për të ndarë eksperiencë dhe për të përmirësuar marrëdhëniet ndërpersonale.

3.5.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin nxënësit të ndajnë përvoja të mira dhe arritjet pozitive mes tyre dhe me të tjerët, për të krijuar një mjedis, ku mund të ndërtohet mirëkuptimi dhe respekti reciprok mes grupeve të ndryshme në shkollë.

3.5.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social nxisin nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, për të punuar së bashku dhe për të mbështetur marrëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe stafit.

3.5.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë grupe diskutimi me nxënësit, ku ata mund të flasin dhe të diskutojnë për tema që lidhen me marrëdhëniet ndërpersonale, si miqësia, bashkëpunimi dhe respekti, për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale.

3.5.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktivitete socio-emocionale dhe lojëra në grup, që inkurajojnë nxënësit dhe stafin të punojnë së bashku dhe të ndërtojnë bashkëpunim dhe marrëdhënie më të forta.

3.5.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me mësuesit, për të krijuar një model të sjelljes pozitive, që nxënësit mund të ndjekin, për të ndihmuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale të shëndetshme.

- 3.5.8.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ofrojnë udhëzime dhe këshilla për prindërit, duke i ndihmuar ata të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të mbështesin zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve të tyre.
- 3.5.9.** Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin metoda dhe teknika efektive, për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe stafit, duke i ndihmuar të ndërtojnë një komunikim të hapur dhe të respektueshëm.
- 3.5.10.** Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë trajnime për nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës, për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi dhe teknika për ndërtimin e komunikimit të hapur dhe të shëndetshëm mes tyre, duke kontribuar në marrëdhëniet më të mira shkollore dhe familjare.
- 3.5.11.** Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë nxënësit të zhvillojnë ndjeshmëri dhe të tregojnë respekt ndaj ndjenjave dhe nevojave të bashkëmohatarëve dhe stafit, duke i mësuar ata të vlerësojnë diversitetin dhe të përfshijnë të tjerët në aktivitetet shkollore.
- 3.5.12.** Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë një kulturë shkollore që mbështet dhe shpërblen sjelljen bashkëpunuese dhe të respektueshme, duke nxitur nxënësit dhe stafin të angazhohen në aktivitete dhe qëndrime pozitive që kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve ndërpersonale.
- 3.5.13.** Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërhyjnë për të ndihmuar në zgjidhjen e keqkuptimeve dhe tensioneve ndërmjet prindërve dhe stafit shkollor me teknika ndërmjetësimi, për të siguruar një komunikim të hapur dhe konstruktiv.
- 3.5.14.** Punonjësit e shërbimit psiko-social monitorojnë në vijimësi marrëdhëniet ndërpersonale ndërmjet nxënësve, stafit dhe prindërve, për të siguruar që të gjitha palët të ndihen të mbështetura dhe të kenë mundësi për të përmirësuar marrëdhëniet e tyre, me mbështetje të vazhdueshme.

Fusha e cilësisë 4: Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

Treguesi 4.1: Punonjësit e shërbimit psiko-social komunikojnë në vijimësi me familjet dhe komunitetin në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse.

<p>4.1.1 Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë takime periodike me prindërit/kujdestarët ligjorë, për të diskutuar progresin dhe mirëqenien e fëmijëve, për të vlerësuar nevojat psiko-sociale dhe për të përcaktuar qëllimet e përbashkëta.</p>
<p>4.1.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social përshtasin qasjen e komunikimit në përputhje me kulturën dhe nivelin e njohurive të çdo familjeje, duke siguruar që informacioni të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë.</p>
<p>4.1.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë në vijimësi prindërit/kujdestarët ligjorë për aktivitetet, ndërhyrjet dhe progresin e bërë nga nxënësit, duke siguruar transparencë të plotë për familjet.</p>
<p>4.1.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë familjet për qasjet dhe metodat e përdorura në ndërhyrjet psiko-sociale të nxënësve, duke shpjeguar ndikimin e tyre në mirëqenien së fëmijës.</p>
<p>4.1.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë familjet për strategjitë dhe aktivitetet që familjet mund të përdorin në kontekstin familjar, për të mbështetur progresin psiko-social të fëmijës.</p>
<p>4.1.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social këshillojnë dhe mbështesin familjet për të kuptuar dhe për të përballuar sfidat psiko-sociale.</p>
<p>4.1.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të qartë dhe të hapur në dhënien e informacioneve, për qëllimet, proceset dhe rezultatet e ndërhyrjes psiko-sociale me familjen dhe komunitetin.</p>
<p>4.1.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur ndaj pyetjeve dhe shqetësimeve të familjarëve dhe të anëtarëve të komunitetit.</p>

4.1.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë rezultatet e ndërhyrjeve psiko-sociale me familjet, duke treguar se cilat janë përmirësimet dhe sfidat e vazhdueshme.

4.1.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin komente dhe sugjerime nga familjet për përmirësimin e shërbimeve dhe për t'u siguruar që ndërhyrjet janë në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.

4.1.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë respektimin e privatësisë së familjeve dhe të nxënësve gjatë ndarjes së informacionit, duke i dhënë rëndësi të veçantë konfidencialitetit.

Treguesi 4.2: Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë rregullisht trajnime dhe sesione informuese për prindërit, duke u ofruar atyre njohuri mbi shëndetin mendor, menaxhimin e sjelljes dhe teknika mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e fëmijëve

<p>4.2.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë seanca ndërgjegjësuese me prindërit për rëndësinë e shëndetit mendor dhe ndikimin e tij në sjelljen dhe suksesin e fëmijëve.</p>
<p>4.2.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë me prindërit ndikimin e stresit shkollor, ankthit, depresionit, bullizmit etj., në mirëqenien e fëmijëve.</p>
<p>4.2.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë prindërit për menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve, duke i trajnuar mbi teknikat për të menaxhuar dhe për t'u përballur me situata të vështira në mënyrë konstruktive.</p>
<p>4.2.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë prindërit për strategji të ndryshme, për ndërtimin e një mjedisi familjar që mbështet zhvillimin emocional dhe social të fëmijëve, si dhe për zgjidhjen e konflikteve.</p>
<p>4.2.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë prindërit për krijimin e një mjedisi mbështetës që nxit të nxënit dhe zhvillimin e aftësive jetësore.</p>
<p>4.2.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin udhëzime prindërve, për të forcuar marrëdhëniet prind-fëmijë dhe për të ndërtuar vetëbesimin te fëmijët.</p>
<p>4.2.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë takime me prindër në mjediset e shkollës, për të diskutuar në mënyrë interaktive me shembuj praktikë dhe skenarë të zakonshëm.</p>
<p>4.2.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin platforma virtuale, për të përfshirë edhe prindërit që nuk mund të marrin pjesë fizikisht, me prezantime multimediale dhe seanca pyetje-përgjigje.</p>

4.2.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë prindërit përmes broshurave dhe udhëzuesve të thjeshtë, mbi tema specifike, video ose infografikë, për ta bërë përmbajtjen më të kuptueshme dhe të lehtë për t'u zbatuar.
4.2.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë këshillime individuale për raste të veçanta, bazuar në nevojat specifike të familjeve.
4.2.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin prindërve udhëzime për identifikimin e shenjave të bullizmit dhe trajtimin e tij.
4.2.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë prindërit me strategji praktike për fëmijët, në përballimin e stresit shkollor dhe social.
4.2.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë familjet, që fëmijët të përdorin teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme.

Treguesi 4.3: Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë diversitetin e familjeve dhe të komunitetit, si një vlerë e shtuar dhe një burim pasurimi kulturor, social dhe emocional për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.

<p>4.3.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social mbledhin informacione rreth burimeve të komunitetit që janë të rëndësishme për familjet dhe zhvillimin e nxënësve.</p>
<p>4.3.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë aktiviteteve që synojnë edukimin e nxënësit, të mësuesit dhe të prindërit, mbi rëndësinë e respektimit dhe të vlerësimit të kulturave dhe të identiteteve të ndryshme.</p>
<p>4.3.3. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajnojnë stafin, për t'i ndihmuar të jenë të ndjeshëm ndaj diversitetit kulturor, ekonomik, gjinor apo të identiteteve të tjera të nxënësve dhe të familjeve.</p>
<p>4.3.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjithë aktorët e shkollës, për krijimin e materialeve edukative që reflektojnë një shumëllojshmëri identitetesh dhe kulturash, duke normalizuar kështu, diversitetin dhe duke e konsideruar atë një pjesë natyrale të mjedisit të shkollës.</p>
<p>4.3.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjitha familjet, pavarësisht prejardhjes së tyre kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore.</p>
<p>4.3.6. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe edukimin e diversitetit, si dhe për të sfiduar dhe për të trajtuar stereotipet.</p>
<p>4.3.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me stafin e shkollës, nxënësit, prindërit dhe me komunitetin, për organizimin e veprimtarive që lidhen me njohjen e kulturës, së traditave dhe të zakoneve krahinore.</p>
<p>4.3.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis përfshirës dhe mbështetës për nxënësit nga familje dhe prejardhje të ndryshme, për t'u ndjerë pjesë e shkollës dhe për të pasur hapësira ku mund të ndajnë përvojat e tyre unike.</p>
<p>4.3.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë diskutimeve të hapura me nxënësit, për të nxitur dialogun ndërmjet tyre, për të ndarë përvojat e tyre, duke theksuar vlerën e</p>

mësimin nga njëri-tjetri dhe kuptimit të diversitetit kulturor dhe familjar, si një pasuri për shkollën.

4.3.10. Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë familjet nga kultura të ndryshme, për të kontribuar në jetën e shkollës, duke marrë pjesë në aktivitete, festa, takime, për të promovuar një atmosferë harmonie ndërkulturore.

4.3.11. Punonjësit e shërbimit psiko-social organizojnë projekte, nisma vullnetare, që përfshijnë nxënës, prindër dhe anëtarë të komunitetit, stafin e shkollës, që shërbejnë për të lidhur kulturat dhe për të promovuar solidaritetin ndërmjet nxënësve nga familje të ndryshme.

4.3.12. Punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë takime ndërgjegjësuese me të gjithë aktorët e shkollës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qarta kundër diskriminimit dhe bullizmit, në lidhje me përkatësinë etnike, kulturore, racore ose sociale të nxënësve dhe të familjeve.

4.3.13. Punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me të gjithë aktorët e shkollës, për të përfshirë nxënësit nga çdo lloj sfondi në çdo aktivitet të shkollës, duke siguruar që të trajtohen me respekt.

Treguesi 4.4: Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme, të besueshme dhe të ndershme me familjet dhe komunitetin, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku interesat e fëmijëve janë gjithmonë në qendër të vëmendjes.

<p>4.4.1. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë që mjedisi i shkollës të jetë një vend ku familjet ndihen të mirëpritura dhe ku të gjitha palët punojnë së bashku në interesin më të mirë të fëmijëve.</p>
<p>4.4.2. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë mundësi për përfshirjen aktive të prindërve dhe të komunitetit në aktivitetet shkollore.</p>
<p>4.4.3. Punonjësit psiko-social krijojnë mundësi për përfshirjen aktive të prindërve në vendimmarrjet që lidhen me mirëqenien e fëmijëve, duke promovuar një ndjenjë bashkëpunimi dhe përkatësie.</p>
<p>4.4.4. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndajnë me familjet të gjitha informacionet mbi zhvillimin dhe mirëqenien e nxënësve, në mënyrë transparente dhe të qartë.</p>
<p>4.4.5. Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë një mjedis, ku prindërit ndihen të dëgjuar dhe të respektuar.</p>
<p>4.4.6. Familjet dhe komuniteti ndajnë lirshëm shqetësimet dhe nevojat e tyre me punonjësin e shërbimit psiko-social.</p>
<p>4.4.7. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë familjet, duke ofruar mbështetje në përshtatje me nevojat e tyre specifike.</p>
<p>4.4.8. Punonjësit e shërbimit psiko-social trajtojnë me respekt dhe konfidencialitet informacionet e ndara me familjen dhe komunitetin, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm.</p>
<p>4.4.9. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndihmojnë në krijimin e një ndjenje përkatësie dhe mbajtjes së lidhjeve midis shkollës, familjes dhe komunitetit, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës.</p>

SHKALLËT E VLERËSIMIT

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor ofron një qasje të strukturuar për vlerësimin e cilësisë së shërbimit psiko-social, duke u bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare për vlerësimin e cilësisë së aktiviteteve trajnuese.

Shkalla e vlerësimit bazohet në kritere të standardizuara, që përfshihen në proceset e vlerësimit. Ajo është krijuar duke marrë parasysh kompetencat profesionale të punonjësve të shërbimit psiko-social, standardet profesionale, metodologjinë e përdorur dhe përmbushjen e rezultateve të pritshme.

Shkalla e vlerësimit është një metodë e përdorur për të vlerësuar gjykimin *me shprehje* ose *me numra*, në lidhje me një aspekt, objekt, karakter ose një atribut të veprimitarisë së shërbimit psiko-social në shkollë. Shkalla e vlerësimit dhe normat përkatëse të vlerësimit përbëjnë sistemin që përdoret nga vlerësuesi gjatë vlerësimit të cilësisë.

Shkalla e vlerësimit ndihmon për të ofruar një analizë të detajuar të cilësisë së një ofruesi, të aktiviteteve trajnuese, duke mundësuar identifikimin e pikave ku nevojiten përmirësime dhe forcimin e aspekteve të forta.

Përshkruesit praktikë vlerësohen me shkallën numerike sipas niveleve të vlerësimit nga 1 në 4, ku shkalla 1 është niveli më i ulët i cilësisë dhe shkalla 4 është niveli më i lartë i saj.

Nivelet e vlerësimit	Vlerësimi përkatës
4	Vlerësim shumë pozitiv
3	Vlerësim pozitiv
2	Vlerësim negativ
1	Vlerësim shumë negativ

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas shkallës së cilësisë, referuar shprehjeve: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “Dobët” (kritike), në përputhje me normën e vlerësimit.

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas formulës:

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas formulës: (Diferenca e **shumës** së përshkruesve (të vlerësuar) me **numrin** e përshkruesve të treguesit) / (Diferenca e **pikëve maksimale** të mundshme me **pikët minimale** të përshkruesve të treguesit) x 100.

Për shembull:

- **Treguesi 1.1. "Punonjësit e shërbimit psiko-social mbështesin nxënësit në menaxhimin e emocioneve dhe sjelljeve problematike"**. ka 15 përshkrues në total.
- Shuma e përshkruesve të vlerësuar është p.sh.: 35.
- Vlerësimi minimal është 15 (15x1) dhe vlerësimi maksimal është 60 (15x4), diferenca e pikëve është 45.
- Vlerësimi i treguesit 1.1. = $((35-15)/(60-15)) \times 100 = (22/39) \times 100 = 44.44\%$ (Mirë)

$$\frac{\text{Diferenca e shumës së përshkruesve (të vlerësuar) me numrin e përshkruesve të treguesit}}{\text{Diferenca e pikëve maksimale të mundshme me pikët minimale të përshkruesve të treguesit}} \times 100 = \text{Norma e vlerësimit të treguesit}$$

Treguesit e cilësisë kanë peshë të barabartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimit psiko-social kryhet sipas formulës:

$$\frac{F1 + F2 + F3 + F4}{4} = \text{Norma e vlerësimit të përgjithshëm të shërbimit psiko-social.}$$

Norma e vlerësimit është model standard, që përcakton shkallën e cilësisë sipas nivelit të vlerësimit.

Tabela e vlerësimit të përgjithshëm të shërbimit psiko-social:

Norma e vlerësimit	Shkalla e cilësisë	Rekomandime
83.33% - 100%	Shumë mirë	Të ruhet cilësia.
50% - 83.32%	Mirë	Ka nevojë për disa përmirësime të vogla.
16.66% - 49.99%	Mjaftueshëm	Ka nevojë për përmirësime në disa fusha.
deri në 16.65%	Dobët	Kërkon rishikim të plotë të shërbimeve të ofruara.

Më poshtë, janë paraqitur përshkrime të përgjithshme të vlerësimeve, të cilat përdoren gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë së shërbimit psiko-social.

Përshkruesit praktikë vlerësohen sipas niveleve të vlerësimit: 1, 2, 3, 4.

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas shkallës së cilësisë, në përputhje me normën e vlerësimit të përshkruesve praktikë, përkatësisht:

- **Shumë mirë:** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar 83.33% - 100% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- **Mirë:** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar 50% - 83.32% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- **Mjaftueshëm:** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar 16.66% - 49.99% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- **Dobët:** kur punonjësit e shërbimit psiko-social kanë realizuar deri në 16.65% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.

RISKU DHE SFIDAT E VLERËSIMIT TË SHËRBIMIT

PSIKO-SOCIAL

Rreziqet dhe sfidat që lidhen me Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-Social Shkollor janë të shumta dhe kërkojnë një angazhim të vazhdueshëm dhe të koordinuar nga të gjithë aktorët e përfshirë. Ndërsa ky dokument në shkolla, është një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve për nxënësit, ai gjithashtu, përballë me disa risqe dhe sfida që mund të ndikojnë në efektivitetin dhe implementimin e saj. Përdorimi i kornizës kërkon një angazhim të gjerë nga ana e autoriteteve shkollore, punonjësve psiko-socialë, mësuesve, prindërve dhe komunitetit. Ja disa nga rreziqet dhe sfidat kryesore që lidhen me kornizën e vlerësimit të cilësisë:

Mungesa e burimeve

Një nga sfidat më të mëdha për zbatimin e një kornize të suksesshme të vlerësimit të cilësisë është mungesa e burimeve financiare dhe logjistike. Shërbimi psiko-social në shumë shkolla mund të mos ketë mjetet e nevojshme, për të mbështetur aktivitetet e vlerësimit dhe për të realizuar trajnime të nevojshme për stafin. Pa financimin dhe burimet e duhura, është e vështirë të realizohen objektivat e vlerësimit të cilësisë dhe të sigurohet një mbështetje adekuate për nxënësit që kanë nevoja të ndryshme psiko-sociale.

Mosmarrëveshjet në interpretimin dhe implementimin e kornizës

Një tjetër sfidë është mungesa e një interpretimi të përbashkët dhe të qartë të kornizës nga të gjithë aktorët e përfshirë. Shumë herë, mund të ketë ndryshime në mënyrën se si korniza kuptohet dhe zbatohet nga punonjësit psiko-socialë, mësuesit dhe drejtorët e shkollës. Kjo mund të çojë në mospajtime në lidhje me përpjekjet për vlerësim, vështirësi në zbatimin e metodave dhe pasiguri në lidhje me kriteret që duhen përdorur për vlerësimin e cilësisë.

Ndikimi i faktorëve të jashtëm

Korniza duhet të marrë parasysh faktorët e jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e nxënësve, si p.sh., kushtet ekonomike dhe sociale. Nxënësit që përballen me kushte të vështira jetese, si varfëria ose dhuna familjare, mund të kenë nevoja të veçanta, që nuk mund të mbulohen plotësisht nga shërbimi psiko-social i shkollës. Kjo mund të sjellë një mangësi në përputhshmërinë e shërbimit, me realitetin e jetës së nxënësve dhe të krijojë pengesa në implementimin efektiv të kornizës.

Ndërgjegjësimi dhe angazhimi i duhur i familjeve dhe i komunitetit


Një tjetër sfidë është mungesa e ndërgjegjësitimit dhe e angazhimit të duhur të familjeve dhe të komunitetit. Shërbimi psiko-social ka më shumë mundësi për të qenë efektiv, kur ka mbështetje të plotë nga prindërit dhe komuniteti. Por, shpeshherë, familjet mund të mos e kuptojnë plotësisht rëndësinë e shërbimeve psiko-sociale dhe nuk janë të gatshëm të angazhohen në proceset e vlerësimit dhe të përmirësimit. Kjo mund të kufizojë efektivitetin e shërbimit dhe të pengojë krijimin e një mjedisi të përbashkët mbështetës për nxënësit.

Diversiteti i nevojave të nxënësve

Shkollat janë të mbushura me një diversitet të gjerë të nxënësve, duke përfshirë ata që kanë nevoja të veçanta edukative, sociale dhe emocionale. Për këtë arsye, përshtatja e shërbimit psiko-social për të përmbushur këto nevoja është një sfidë e madhe. Korniza duhet të jetë fleksibël dhe të sigurojë mundësi për të adresuar nevojat individuale të nxënësve, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara ose ata që përballen me probleme të veçanta familjare dhe sociale. Kjo kërkon një punë të vazhdueshme, për të përshtatur shërbimin dhe për të siguruar që çdo nxënës të marrë mbështetje të duhur.

Rezistenca ndaj ndryshimeve dhe inovacionit

Zbatimi i një kornize të vlerësimit të cilësisë, mund të ndeshet me rezistencë nga ana e disa mësuesve, punonjësve të shërbimit psiko-social dhe drejtuesve të shkollës. Disa prej tyre, mund



të ngurojnë për të pranuar dhe për të zbatuar ndryshime të reja, sidomos kur ato kërkojnë një qasje të re në mënyrën e menaxhimit të shërbimeve psiko-sociale ose kur ndihen të pasigurt në lidhje me efektivitetin e kornizës. Kjo mund të pengojë përparimin dhe të vonojë përmirësimet e nevojshme.

Si përfundim, mungesa e burimeve, vështirësitë në përcaktimin e standardeve të matshme dhe ndikimi i faktorëve të jashtëm, janë disa nga pengesat më të rëndësishme që mund të ndikojnë në realizimin e kësaj kornize. Megjithatë, përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe një angazhimi të plotë, këto sfida mund të tejkalohen dhe shërbimi psiko-social mund të ofrojë mbështetje të efektshme dhe të qëndrueshme për nxënësit.

BAZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025).
- Vendimi nr. 733, datë 20.10.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe të planit të veprimit”.
- Vendimi nr. 98, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”.
- Vendimi nr. 99, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)”.
- Vendimi nr. 276, datë 12.5.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”.
- Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj”.
- Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzim nr. 15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 26, datë 02.08.2013, “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Këshillit të Mësuesve”.
- Udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, “Për rregulloren Tip të institucioneve arsimore”.
- Udhëzimi nr. 43, datë 21.08.2013, “Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike”.

- Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”.
- Udhëzimi nr. 10, datë 25.02.2015, katërministror midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.
- Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”, i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor”.
- Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”.
- Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.
- Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 1.12.2021; nr. 28 datë 3.8.2022 dhe nr. 17, datë 26.7.2023.
- Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
- Udhëzimi nr. 10, datë 06.05.2022, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin profesional të rrjetit kombëtar të monitoruesve, vlerësuesve dhe vlerësuesve me bazë rrisht për institucionet arsimore parauniversitare”.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, për “Numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”.
- Urdhri nr. 8, datë 12.01.2017, “Për miratimin e kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor dhe standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç”.
- Urdhër nr. 100, datë 25.2.2022, “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- Marrëveshja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Agjencinë Ekzekutive për Arsimin, Mediet Audiovizive dhe Kulturën e Komisionit Evropian.
- Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30.11.2013.
- Standardet profesionale të vlerësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare, ASCAP 2021.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

BIBLIOGRAFIA

“Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor”, ASCAP 2022

<https://www.efpa.eu/sites/default/files/2023-04/meta-code-of-ethics.pdf>

<https://www.efpa.eu/mental-health>

<https://www.schoolcounselor.org/Standards-Positions/Standards>

<https://iris.ëho.int/bitstream/handle/10665/367426/9789240064751-eng.pdf?sequence=1>

<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000387380>

<https://psychology.org.au/aps/media/resource-finder/frameëork-delivery-school-psych-services-practice-guide.pdf>

<https://education.nsw.gov.au/content/dam/main-education/about-us/educational-data/cese/2020-school-counselling-service-expansion-final-report.pdf>

https://planipolis.iiep.unesco.org/sites/default/files/ressources/ireland_wellbeing-policy-statement-and-framework-for-practice-2018-2023.pdf

<https://www.ptsd.va.gov/professional/articles/article-pdf/id30225.pdf>

<https://www.saasso.asn.au/ëp-content/uploads/2013/04/National-School-Chaplaincy-and-Student-Welfare-Program-Guidelines.pdf>

<https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/376208/9789240087149-eng.pdf>

<https://cms.bps.org.uk/sites/default/files/2022-06/BPS%20Response%20-%20Ofsted%20Education%20Inspection%20Frameëork%202019.pdf>

<https://casponline.org/pdfs/publications/CASP%20Guide%20for%20Evaluation%20of%20School%20Psychologists.pdf>

https://healthyschoolsbc.ca/media/8768/csh_knowledge_guide_-_electronic_copy_final_2013.pdf

<https://citeseerx.ist.psu.edu/document?repid=rep1&type=pdf&doi=57b079676795a2ef7c49ad84928541137c4acc17>

<https://www.eursc.eu/Documents/Final%20Report%20External%20Evaluation%20Education%20Support.pdf>

<https://www.hel.fi/static/kasko/hki-student-welfare-plan.pdf>

https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/toolbox_me-framework_final.pdf/

https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5f80476f8fa8f51e7edfa0d7/MHSSL_Evaluation_FINAL_for_gov.uk.pdf

https://casponline.org/casp-webinars/nasp-professional-standards/NASP%20Practice%20Model%20Overview_2020_handout.pdf

<https://education.gov.scot/media/buvduifa/qualitymanagementlaedpsychservices1.pdf>

<https://nc02200844.schoolwires.net/site/handlers/filedownload.ashx?moduleinstanceid=365&dataid=1203&FileName=School%20Psychologist%20Evaluation%20User%20Guide.pdf>

<https://aep.org.uk/system/files/2022-12/The%20Evaluation%20of%20Educational%20Psychology%20Services%20in%20the%20Light%20of%20Outcomes%20for%20Children%20%282%29.pdf>

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/project-result-content/2cd7d83e-a5c0-4ca0-b55a-9a18515bacb8/IO1_EN.pdf.



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

